



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

PROGRAMI NACIONAL PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2030

Shtator 2023

Përmbajtja

Akronimet	2
Përmbledhja ekzekutive	3
1. Hyrja	5
2. Metodologjia	7
3. Konteksti i përgjithshëm	9
4. Analiza SWOT	11
5. Përmbledhja e analizës së problemeve	12
6. Ndërlidhja me dokumentet strategjike relevante	17
7. Vizioni, objektivat dhe masat	19
Objektivi 1: Ekonomi lokale konkurruese	20
Objektivi specifik 1.1: Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal	20
Objektivi specifik 1.2: Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal	21
Objektivi specifik 1.3: Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion	22
Objektivi 2: Punësim gjithëpërfshirës	23
Objektivi specifik 2.1: Zvogëlimi i hendekut të shkathtësive në tregun e punës	23
Objektivi specifik 2.2: Rritja e punësimit të dinjitetshëm për gra, të rinj dhe kategori të cenueshme	23
Objektivi 3: Infrastrukturë lokale e përmirësuar	24
Objektivi specifik 3.1. Përmirësimi infrastrukturës së transportit lokal dhe shërbimeve	24
Objektivi specifik 3.2: Sigurimi i qasjes në infrastrukturë përcjellëse	25
Objektivi specifik 3.3: Menaxhimi i integruar i mbeturinave	25
Objektivi specifik 3.4: Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në infrastrukturë	26
Objektivi 4: Qeverisje ekonomike efektive dhe bashkëpunuese	27
Objektivi specifik 4.1: Financa të pushtetit lokal të qëndrueshme dhe efektive	27
Objektivi specifik 4.2: Avancimi i proceseve dhe resurseve në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale	28
Objektivi specifik 4.3: Përmirësimi i shërbimit dhe përgjegjshmërisë komunale	29
Objektivi specifik 4.4: Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal	29
Treguesit	31
8. Zbatimi, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi	34
9. Projektionet financiare për zbatim të PNZHEL	36
Shtojcat Gjetjet kryesore të anketës me komuna	38

Akronimet

ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BP	Ballkani Perëndimor
DEMOS	Projekti për Decentralizim dhe Mbështetje të Komunave
IHD	Investimet e Huaja Direkte
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
PBV	Produkti Bruto Vendor
PKZH	Plani Kombëtar për Zhvillim
PNZHEL	Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SDG	Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Përmbledhja ekzekutive

Zhvillimi ekonomik lokal është një proces që ka për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve, duke nxitur rritjen e investimeve, stimuluar ndërmarrjet me potencial zhvillimi, promovuar krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe duke ngritur infrastrukturën e nevojshme për ta lehtësuar bashkëpunimin midis palëve. Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal (PNZHEL 2030) synon të lokalizojë përcaktimet strategjike që dalin nga Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim (SKZH dhe PKZH 2030) dhe strategjitë relevante sektoriale të nivelit qendror. PNZHEL 2030 kryesisht fokusohet në çështje ekonomike që prekin shumicën dërrmuese të komunave, por njëkohësisht adreson edhe çështje që i takojnë nivelit qendror, të tilla që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal. Ky program pritet të shërbejë si bazë për komunat, ashtu që ato t'i hartojnë strategjitë e tyre të zhvillimit ekonomik në përputhje me kornizën strategjike ekonomike të hartuar në nivel vendi.

Procesi i hartimit të PNZHEL 2030 është udhëhequr nga Grupi Punues, ku bartëse ishte Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Puna është zhvilluar në dy drejtime: në njërën anë, janë identifikuar sfidat dhe orientimet e përgjithshme nga nivelit qendror, ndërsa në anën tjetër, është nxjerrë perspektiva e nivelit lokal përmes mjeteve të ndryshme për mbledhje të të dhënave. Procesi i hartimit ka qenë gjithëpërfshirës, ku përveç angazhimit të përfaqësuesve nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal, janë përfshirë edhe përfaqësues nga organizata të ndryshme, shoqata të biznesit dhe palë të tjera relevante. Duhet theksuar se gjatë përcaktimit të kornizës metodologjike janë marrë në konsideratë: "Udhëzimi Administrativ për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit" dhe "Manuali për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit".

Përkundër bazës së mirë rregullative dhe përpjekjeve të bëra ndër vite, shumica e komunave të Kosovës ende nuk kanë planifikim cilësor për zhvillim ekonomik lokal dhe sfidohen me probleme të natyrave të ndryshme. Disa nga problemet janë mungesa e investimeve, shpërputhja e aftësive në tregun e punës, mungesa qëndrueshmërisë financiare dhe bashkëpunimi i kufizuar.

Vizioni i këtij programi është "Krijimi i një ekonomie lokale të qëndrueshme, të larmishme dhe të përshtatshme ndaj ndryshimeve, që sjell zhvillim dhe prosperitet për të gjithë". Për ta arritur këtë vizion deri në 2030-ën, PNZHEL ka paraparë katër objektiva kryesore, të cilat janë: (1) Krijimi i një ekonomie lokale konkurruese; (2) Promovimi i punësimit gjithëpërfshirës; (3) Përmirësimi i infrastrukturës lokale dhe (4) Qeverisja ekonomike efektive dhe bashkëpunuese. Objektivi 1 parashihet të arrihet duke rritur investimet në fusha me potencial për zhvillim ekonomik lokal; ngritur produktivitetin në bujqësi dhe promovuar turizmin lokal; dhe përkrahur ndërmarrësinë me fokus në digjitalizim dhe inovacion. Objektivi 2 pritet të përmbushet duke zvogëluar hendekun e shkathtësive në tregun e punës dhe duke rritur punësimin e dinjitetshëm për gra, të rinj dhe grupe të cënueshme. Objektivi 3 pritet të realizohet përmes përmirësimit të infrastrukturës së transportit lokal dhe shërbimeve; sigurimit të qasjes në infrastrukturën përcjellëse; menaxhimit të integruar të mbeturinave; dhe përmirësimit të efikasitetit të energjisë në infrastrukturë. Në fund, Objektivi 4 parashihet të arrihet përmes financave lokale të qëndrueshme dhe efektive; avancimit të proceseve dhe resurseve në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale; përmirësimit të shërbimeve dhe përgjegjësisë komunale; dhe forcimit të partneritetit për zhvillim ekonomik lokal.

Implementimi i këtij programi kërkon bashkëpunim të ngushtë ne mes të institucioneve, komunitetit të bizneseve dhe qytetarëve. Përmes bashkëpunimit në zbatim, krijohen kushte që të ndërtohet një ekonomi lokale që nxit rritjen dhe zhvillimin për të gjithë.

1. Hyrja

Zhvillimi ekonomik lokal jep kontribut qenësor në performancën e përgjithshme ekonomike të shtetit. Rëndësia e zhvillimit në këtë nivel po bëhet gjithnjë e më kritike si rezultat i rritjes së konkurrencës në nivel global, lëvizjes së popullatës, avancimit të teknologjisë dhe dallimeve hapësinore në rritje. Në këtë kontekst, zhvillimi ekonomik lokal është bërë i domosdoshëm për të nxitur investime drejt aktiviteteve që përkojnë me potencialet dhe karakteristikat lokale, për të krijuar vende të reja pune dhe për të shkrië dallimet në mes të vendeve të pasura dhe të varfra.

Komunitetet lokale të suksesshme ekonomisht sot janë ato të cilat krijojnë mekanizma për adresimin e sfidave lokale dhe njëkohësisht zhvillojnë aftësi që t'i adaptohen dinamikave dhe ndryshimeve të vazhdueshme në rrafshin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Zhvillimi ekonomik lokal është pikërisht procesi që e mundëson këtë adaptim, përmes planifikimit me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe dialog të vazhdueshëm lokal dhe bashkërendimit të resurseve brenda dhe jashtë komunitetit.

Për dallim nga shumë vende të tjera, Kosova, të paktën në rrafshin ligjor, e ka të rregulluar mirë çështjen e zhvillimit ekonomik lokal. Në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht në nenin 17, zhvillimi ekonomik lokal është në mesin e kompetencave vetanake të komunave, që, mes tjerash, nënkupton se komunat kanë hapësirë që ta planifikojnë zhvillimin ekonomik lokal të tyre, t'i përcaktojnë përparësitë zhvillimore dhe strukturore, si dhe ta definojnë përkrahjen për zhvillimin e ekosistemit ekonomik lokal.

Përkundër rregullimit të mirë ligjor dhe përpjekjeve ndër vite, shumica e komunave të Kosovës ende nuk kanë planifikim cilësor në lidhje me zhvillimin ekonomik lokal dhe ballafaqohen me sfida sistemike që pengojnë në zhvillimin dhe avancimin e tyre. Ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet niveli komunal në aspekt të zhvillimit ekonomik janë kapacitetet e mangëta komunale për ta ndihmuar zhvillimin ekonomik, mungesa e përkrahjes solide në nxitje të investimeve në sektorët me prioritet, shpërputhja e aftësive në tregun e punës, mungesa e qëndrueshmërisë financiare me varësi të madhe në nivelin qendror dhe bashkëpunimi i kufizuar institucional.

Për ta ndihmuar zhvillimin ekonomik lokal, Qeveria e Kosovës, nën udhëheqjen e MAPL-së dhe në bashkëpunim me institucionet tjera të linjës, komunat dhe akterët tjerë relevantë ka hartuar PNZHEL 2030. Ky dokument ka për qëllim të lokalizojë orientimet strategjike që dalin nga SKZH dhe PKZH 2030 dhe strategjitë sektoriale që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik. Fushëveprimi i këtij programi kornizohet në adresimin e sfidave të cilat i takojnë nivelit lokal. PNZHEL 2030 do të shërbejë si udhërrëfyes për komunat, ashtu që këto të fundit t'i përgatisin strategjitë e tyre të zhvillimit ekonomik lokal në harmoni me përcaktimet përgjithshme strategjike të SKZH-së dhe PKZH-së, si dhe me dokumentet tjera sektoriale të nivelit qendror. PNZHEL 2030 fokusin kryesor e ka në çështje ekonomike që kanë shtrirje horizontale tek komunat, por njëkohësisht edhe në çështje të nivelit qendror që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal. Ky dokument përmban objektiva dhe masa të përgjithshme orientuese. Komunat, në strategjitë e veta për zhvillim ekonomik lokal, do ta kenë mundësinë që të përfshijnë veprime konkrete dhe të bëjnë ndarje buxhetore karshi planifikimeve të tyre.

Vlen të theksohet se aktualisht është në fuqi Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal, e cila pritet të skadojë në 2023-ën. Çështjet relevante nga strategjia aktuale janë bartë tek ky dokument i ri strategjik.

Pjesa tjetër e këtij dokumenti organizohet siç vijon. Seksioni II paraqet shpjegimet metodologjike për hartimin e PNZHEL 2030. Seksioni III tregon kontekstin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Seksioni IV

shfaq analizën SWOT, duke treguar përparësitë, mangësitë në njërin anë dhe në anën tjetër mundësitë dhe rreziqet. Seksioni V bën një përmbledhje të analizës së problemeve. Seksioni VI përmbledh strategjitë kryesore që lidhen me PNZHEL 2030. Seksioni VII paraqet vizionin së bashku me objektivat dhe masat orientuese. Në të njëjtin seksion paraqitet edhe tabela e treguesve. Seksioni VIII shpjegon zbatimin, si dhe kornizën monitoruese dhe raportuese. Në fund, Seksioni IX paraqet paraqet projeksionet financiare për zbatim të PNZHEL 2030.

2. Metodologjia

Në mënyrë që PNZHEL 2030 të jetë sintetizim i politikave ekonomike zhvillimore të nivelit qendror dhe atij lokal, është ndjekur një qasje metodologjike që në boshtin e saj ka dy drejtime. Në njërën anë, është zhvilluar punë në hartëzimin e sfidave dhe përcaktimeve orientuese nga niveli qendror; ndërsa në anën tjetër, përmes instrumenteve të ndryshme për mbledhje të të dhënave, është nxjerrë perspektiva e përgjithshme nga niveli lokal. Gjatë përcaktimit të kornizës metodologjike për hartimin e këtij programi janë marrë parasysh: “Udhëzimi Administrativ për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit” dhe “Manuali për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit”.

MAPL-ja, si bartëse e këtij procesi, ka mundur që procesi i hartimit të PNZHEL 2030 të jetë gjithëpërfshirës dhe shterues në aspekt të diskutimeve dhe konsultimeve, ku përpos pjesëmarrjes së përfaqësuesve nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal, janë përfshirë edhe përfaqësues nga organizata të ndryshme, shoqata të biznesit dhe hisedarë të tjerë. Paralel me synimin që në fund të prodhohet një produkt strategjik cilësor, rëndësi e veçantë i është dhënë edhe vet procesit, duke e shndërruar në një platformë ndërveprimi për palët.

Tabela 1: Procesi i hartimit të PNZHEL

Puna përgatitore	Fillimisht, MAPL ka themeluar Grupin Punues, si ekipin përgjegjës për të drejtuar procesin e hartimit të PNZHEL 2030. ¹ Në të njëjtën kohë, MAPL është dakorduar me projektin zviceran DEMOS, për të pranuar mbështetje në hartimin e këtij dokumenti strategjik.
Punëtorja e parë e Grupit Punues	Gjatë punëtorisë së parë, anëtarët e Grupit Punues kanë shfrytëzuar rastin të njoftohen me njëri-tjetrin, të diskutojnë mbi fushëveprimin e PNZHEL 2030 dhe t'i ndajnë pikëpamjet e tyre mbi atë se si ata/ato e shohin zhvillimin ekonomik lokal në të ardhmen.
Rishikimi i strategjive dhe dokumenteve tjera relevante	Në këtë fazë, Grupi Punues ka rishikuar SKZH-në dhe dokumentet tjera strategjike sektoriale, të miratuara apo në proces të miratimit. Rishikimi i dokumenteve strategjike të nivelit qendror ka qenë i rëndësishëm për të kuptuar më shumë rreth orientimeve strategjike të nivelit qendror që lidhen me zhvillimin ekonomik lokal. Paralel me këtë, është rishikuar korniza përkatëse legjislative dhe institucionale, në mënyrë që të qartësohet më tutje fushëveprimi i këtij dokumenti. Tutje, Grupi Punues ka konsultuar raporte dhe studime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, kryesisht për t'i identifikuar sfidat kryesore të zhvillimit ekonomik lokal. Gjatë kësaj faze, MAPL ka kontaktuar institucione të ndryshme për të mbledhur të dhëna statistikore relevante, të cilat janë shfrytëzuar për të përshkruar kontekstin e përgjithshëm
Punëtorja e dytë e Grupit Punues	Gjatë punëtorisë së dytë, Grupi Punues i ka identifikuar sfidat preliminare të zhvillimit ekonomik lokal dhe pastaj i ka sistemuar ato në sfida madhore. Përpos

¹ Grupi punues kishte këtë përbërje: MAPL, ZKM, MINT, MFPT, MMPHI, MBPZHR, ASK, MASHT, MSH, MEE, AKK, GIZ, OSBE, DEMOS, KLGI.

	kësaj, është punuar në draftin e parë të SWOT analizës dhe janë zhvilluar diskutime për mjetet për mbledhjen e të dhënave shtesë.
Anketa me drejtori të zhvillimit ekonomik dhe biznese	Për të marrë inpute nga niveli lokal rreth sfidave, kapaciteteve dhe mundësive, janë zhvilluar dy anketa: njëra me drejtoritë përkatëse të zhvillimit ekonomik në komunat e Kosovës, ndërsa tjetra me biznese. Si hap i parë në këtë drejtim ka qenë përgatitja e pyetësorëve për të dyja grupet, të cilët kanë përfshirë pyetje kryesisht të natyrës cilësore. Tek bizneset, ka qenë e nevojshme të bëhet edhe një proces i mostrimit, në mënyrë që të ketë perspektiva nga lloje të ndryshme të bizneseve. Nga anketa me drejtori, janë pranuar gjithsej 31 pyetësorë të kompletuar, ndërsa nga ajo me biznese, 57 të tillë. Të dhënat e pranuar janë përpunuar dhe interpretuar, duke e përfshirë secilën pyetje – shihni Shtojcën.
Takimet me komuna dhe me asociacione të biznesit	Në këtë punëtori, Grupi Punues ka prezantuar të dhënat e anketës dhe e ka shfrytëzuar mundësinë që përmes diskutimeve me palët e ftuara, t’i verifikojë dhe shtjellojë më tutje ato. Njëkohësisht, është përgatitur një draft më i avancuar i sfidave dhe problemeve kryesore, duke i kombinuar të gjitha burimet e të dhënave. Në fund, pjesëmarrësit janë ftuar që të diskutojnë rreth objektivave preliminare.
Punëtorja e tretë e Grupit Punues	Në këtë punëtori, Grupi Punues e ka diskutuar dhe përcaktuar vizionin, objektivat dhe masat e përgjithshme të PNZHEL-së. Njëkohësisht, është përcaktuar edhe korniza për monitorimin dhe vlerësimin e këtij programi dhe është bërë një vlerësim i ndikimit financiar. Me përfundimin e kësaj punëtorie, është finalizuar drafti i PNZHEL dhe është përgatitur për konsultime publike.
Konsultimet Publike	Në fund të të gjithë procesit, është organizuar diskutimi paraprak dhe publik me qëllim të marrjes së komenteve dhe inputeve nga hisedarët. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, është punuar në versionin final të dokumentit, i cili në fund është proceduar në Qeveri për aprovim.

3. Konteksti i përgjithshëm

Që nga shpallja e pavarësisë, Kosova pothuajse e ka dyfishuar ekonominë e saj, ndonëse duhet theksuar se baza nga kjo periudhë ka qenë relativisht e ulët. Gjatë viteve 2017-2019, Kosova ka tejkaluar vendet homologe të Ballkanit Perëndimor në aspekt të rritjes së BPV-së reale, me një shkallë mesatare prej 4.3%. Pandemia COVID-19 bëri që hovi i vazhdueshëm i rritjes të ndalet. Ngjashëm me vendet tjera, Kosova përjetoi tkurrje të BPV-së reale prej 5.3% në vitin 2020, e cila megjithatë është rikuperuar suksesshëm në vitin 2021. Në 2021-ën, në fakt, është shënuar një rritje dyshifrore prej 10.5%. Kontribut të ndjeshëm në trendin pozitiv të rritjes ekonomike të vendit gjatë viteve kanë dhënë konsumi, i nxitur konsiderueshëm nga dërgesat dhe vizitat e diasporës, si dhe nga ndihma e huaj.

Inflacioni dhe borxhi përgjithshëm kanë qenë nën kontroll përgjatë viteve, duke bërë që të ketë stabilitet makroekonomik në vend. Megjithatë, që nga 2021-a, inflacioni ka filluar të rritet ndjeshëm, fillimisht si rezultat i kërkesës së shtuar nga pakot stimuluese për adresim të pasojave të pandemisë, e së fundmi, sidomos për shkak të luftës në Ukrainë, ku pasojat janë ndjerë kryesisht në çmime të produkteve bazike, si energjia dhe ushqimi. Në korrik të 2022-ës, ngjashëm me shumicën vendeve të Evropës, Kosova ka shënuar normë të paprecedent të inflacionit me 14.2%. Trend në rritje është vërejtur edhe tek borxhi i përgjithshëm, ndonëse larg përmasave që shihen te rasti i inflacionit.

Tabela 2: Treguesit kryesorë ekonomik

Treguesi	2017	2018	2019	2020	2021
Norma e rritjes së BPV-së reale (%)	4.2	3.4	4.8	-5.3	10.5
BPV (mil. EUR)	6,356.4	6,671.5	7,056.1	6,771.6	7,816.6
Norma e inflacionit (%)	1.5	1.1	2.7	0.2	3.4
Borxhi publik (% e BPV-së)	16.4	17.0	17.6	22.4	21.9
Deficiti tregtar (% e BPV-së)	29.0%	31.8%	31.0%	35.9%	36.1%
<i>Eksportet – mallrat (mil. EUR)</i>	378	367.5	383.5	474.9	749.7
<i>Importet – mallrat (mil. EUR)</i>	3,047.0	3,347.0	3,496.9	3,296.0	4,652.7
<i>Eksportet – shërbimet (mil. EUR)</i>	1,358.8	1,561.6	1,675.1	994.9	1,954.4
<i>Importet – shërbimet (mil. EUR)</i>	531.5	705.8	749.1	603.3	870.7
Investimet e Huaja Direkte (mil. EUR)	255.4	272.1	254.6	345.7	415.3
Investimet e Huaja Direkte (% e BPV-së)	4.0	4.1	3.6	5.1	5.3
Norma e papunësisë (%)	30.5	29.6	25.7	25.9	20.5
<i>Papunësia e grave (%)</i>	36.6	38	34.4	32.3	22.1
<i>Pjesëmarrja në fuqinë punëtore (%)</i>	43	42	40.5	38.3	37.7
Shkalla e varfërisë (% e popullsisë)	18	-	21.1	23.2	19.4

Burimi: ASK dhe BQK

Struktura e gjithmbarshme ekonomike në Kosovë është kryesisht e përqendruar në veprimtari industriale dhe shërbyese, të cilat krijojnë pak vlerë të shtuar në ekonomi. Të dhënat tregojnë se industritë me bazë mesatare ose të lartë të teknologjisë, të cilat parimisht konsiderohen industri të avancuara, përbëjnë vetëm 1% të vlerës së shtuar në vend. Aktivitetet kryesore në industri janë prodhimi (përpunimi) dhe ndërtimi, me kontribut në PBV me 11.7%, respektivisht 8.5%. Ngjashëm edhe tek shërbimet, përkundër

që ato kontribuojnë me pjesën më të madhe në ekonominë e Kosovës (47.5%), vetëm rreth 1/6 e tyre janë shërbime të bazuara në intensitet të lartë të dijes. Strukturën e shërbimeve e dominon tregtia me shumicë dhe pakicë, patundshmëria, transporti dhe shërbimet financiare. Në anën tjetër, kontributi i bujqësisë në ekonominë e Kosovës, ka rënë dukshëm gjatë dekadës së fundit, nga 15% në vitin 2008 në 7% në vitin 2021. Ndonëse sektori privat mban primatin në ekonominë e Kosovës, ende është i brishtë dhe i dominuar nga mikro-ndërmarrjet me kapital të kufizuar.

Kosova konsiderohet vend relativisht i hapur; tregtia (eksportet dhe importet së bashku) përbëjnë një mesatare prej rreth 90% të BPV-së në periudhën 2017-2022. Liberalizimi i tregtisë ndër vite nuk ka prodhuar përmirësim në bilancin tregtar të vendit, me ç'rast deficitin vazhdon të jetë mjaft i lartë, rreth 33% e PBV-së në të njëjtën periudhë. Importi tejet i lartë i mallrave kontribuon më së shumti në këtë deficit, përderisa suficiti në tregtinë e shërbimeve arrin ta zbusë atë deri në një masë. Shkëmbimin më të madh tregtar Kosova e realizon me vendet me të cilat kufizohet dhe shtetet e BE-së, në kuadër të marrëveshjeve për tregti të lire CEFTA-s, përkatësisht MSA-së. Eksportet e Kosovës, si refleksion i strukturës së ekonomisë, nuk përmbajnë produkte dhe shërbime të sofistikuar dhe karakterizohen me shkallë të ulët të mbijetesës në tregjet e huaja. Përkundër trendit dekurajues të eksporteve, rritja e theksuar e tyre në vitin 2021 dhe në gjysmën e parë të 2022, është shprehëdhënëse për potencialin në këtë drejtim.

Investimet e Huaja Direkte (IHD), që rëndom prodhojnë një ndikim të gjerë në ekonomi, në relacion me BPV-në mbeten nën mesataren e vendeve fqinje, ndonëse kanë shënuar një trend pozitiv në fitet e fundit, duke e arritur vlerën më të lartë në 2021-ën, më saktësisht 415.3 milionë Euro. Fluksi më i madh i këtyre investimeve vjen nga diaspora kosovare, kryesisht e koncentruar në Gjermani dhe Zvicër. Sektori që më së shumti thith investime të huaja direkte është patundshmëria. Ky sektor, për nga natyra, prodhon shumë pak efekte përhapëse në ekonomi. Në anën tjetër, dy sektorë shumë të rëndësishëm dhe me potencial për zhvillim ekonomik, prodhimi (përpunimi) dhe teknologjia e informimit dhe komunikimit (TIK), nuk kanë arritur të thithin më shumë se 3.3% të totalit të IHD-ve në vitin 2021.²

Rritja ekonomike e përshkruar më sipër, nuk është përkthyer në përmirësim të ndjeshëm të parametrave zhvillimorë. Pavarësisht përqindjes së lartë të popullsisë në moshë pune (rreth 65%), Kosova vazhdon të ketë papunësinë më të lartë në Evropë, me një normë mesatare prej 26.4% në pesë vitet e fundit. Duhet theksuar se në vitin e fundit, si rezultat i "bumit post-pandemik", është shënuar një rënie relativisht e kënaqshme. Papunësia është posaçërisht e theksuar tek të rinjtë dhe gratë, ku mesatarja e pesë vjetëve të fundit është 48.7%, respektivisht 32.7%. Krahas papunësisë së lartë, Kosova ka nivel të lartë të pasivitetit në tregun e punës, ku vetëm 40.3% e popullsisë në moshë pune ishin aktiv në periudhën 2017-2021. Gjithashtu, Kosova vlerësohet të jetë shteti më i varfër në Evropë, me një normë të varfërisë prej 17%. Te gratë kryefamiljare, kjo normë është ende më e lartë – 23.7%.

² BQK. Seritë kohore - Investimet e Huaja Direkte. Shkurt 2022.

4. Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Infrastruktura ligjore ▪ Burimet e informacionit për potencialet ekonomike ▪ Infrastruktura rrugore e zhvilluar në komunitat më të mëdha ▪ Fuqia e re punëtore me potencial për punë ▪ Prezenca e qendrave për aftësim profesional ▪ Potencialet natyrore për zhvillim të turizmit ▪ Siguria financiare për funksionim bazë të komunës ▪ Lehtësirat ligjore për shfrytëzim të pronës komunale nga investitorët ▪ Zyrat komunale për ofrim të asistencës për çështje bujqësore ▪ Projektet aktuale për bashkëpunim ndërkufitar, sidomos në fushën e turizmit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mungesa kapaciteteve profesionale për hartim të politikave të zhvillimit ekonomik lokal ▪ Inkasimi i të hyrave vetanake vjetore në nivelin e planifikuar ▪ Varësia e madhe buxhetore në grantet qeveritare ▪ Lëvizjet demografike që reflektohen në ndarje buxhetore ▪ Mosfunksionalizimi i zonave ekonomike ▪ Përkrahja e kufizuar e turizmit dhe bujqësië ▪ Përgatitja jo e duhur e fuqisë punëtore për t'i përmbushur nevojat e tregut ▪ Pengesat që ndërlidhen me definimin e titujve pronësorë ▪ Menaxhimi jo i duhur i pronës komunale ▪ Mungesa e pronës komunale për ta shfrytëzuar për qëllime investuese ▪ Definimi jo i qartë i kompetencave në mes të nivelit lokal dhe qendror ▪ Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes komunave dhe me nivelin qendror ▪ Mungesa e shkathtësive në tregun e punës për përmbushje të nevojave të sektorit privat ▪ Mungesat e mbështetjes së grave për t'u përfshirë në tregun e punës ▪ Fragmentarizmi i parcelave bujqësore ▪ Mungesa e infrastrukturës dhe vetëdijesimit për riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave ▪ Mungesa e planifikimit të përgjegjshëm urban
Rreziqet	Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Inflacioni i importuar nga vendet e huaja ▪ Situatat e jashtëzakonshme (pandemitë, fatkeqësitë natyrore, etj.) ▪ Largimi i kuadrit profesional ▪ Vendimet e pakoordinuara nga niveli qendror me efekt negativ financiar në komuna 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gatishmëria e investitorëve për të investuar në Ballkanin Perëndimor ▪ Disponueshmëria e fondeve të donatorëve ▪ Grante specifike nga niveli qendror për nivelin komunal ▪ Përdorimi i teknologjisë digjitale moderne ▪ Bashkëpunimi me diasporën për investime të përbashkëta dhe transferim të dijes ▪ Tregjet e përbashkëta ndër-komunale

5. Përmbledhja e analizës së problemeve

Komunat kanë zvogëluar ndjeshëm ngarkesat administrative që ndërlidhen me themelimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve, duke kontribuar kështu në përmirësimin e gjithmbarshëm të klimës së të bërit biznes. Përkundër këtij progresi, ndërmarrjet ende ballafaqohen me sfida të shumta që ua pamundësojnë realizimin e potencialit të tyre konkurrues. Në anketën e zhvilluar me biznese për nevojat e këtij programi, konkurrenca e pandershme, qasja e kufizuar në financa dhe praktikat korruptive, renditen në mesin e barrierave kryesore që pengojnë zhvillimin ekonomik lokal. Dy të parat figurojnë në mesin e pesë barrierave kryesore edhe në një anketë të zhvilluar rishtazi nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), krahas atyre që kanë të bëjnë me koston e energjisë elektrike dhe qasjen në të.³

Investimet në nivelin komunal janë të kanalizuar kryesisht në projekte të natyrës infrastrukture, sidomos në rrugë. Prona komunale dhe mundësia që ajo të ofrohet për shfrytëzim përbën një mjet të rëndësishëm për komunën për t'i stimuluar investimet. Aktualisht mbi 90% e komunave janë deklaruar ta kenë bërë inventarizimin e pronave të tyre. Pjesa më e madhe, madje, janë të qasshme për publikun. Përkundër inventarizimit të kryer, në shumë raste nuk është bërë klasifikimi për ta qartësuar se cilat prona janë të lira dhe të gatshme për shfrytëzim. Disa prej komunave nuk kanë fare në dispozicion prona që mund të jepen, për t'u shfrytëzuar për qëllime investuese. Deri tash, sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), përvojat sa i përket dhënies së pronave në shfrytëzim nuk kanë qenë shumë të mira.⁴ Janë dokumentuar vështirësi në mbledhjen e qirave, konteste gjyqësore dhe kontrata të dëmshme.

Spektori privat, duke qenë i dominuar nga mikro-ndërmarrjet në pronësi familjare, ka qenë pak i gatshëm të realizojë investime me efekte të konsiderueshme për zhvillimin ekonomik lokal. Ngjashëm, investimet e huaja në aktivitete ekonomike më vlerë të shtuar dhe me potencial punësimi kanë qenë në nivel jo të kënaqshëm. Zonat ekonomike apo parqet industriale, ndonëse të krijuara në disa komuna kryesore për të thithur investime, deri tash shumë pak kanë arritur t'i shërbejnë këtij qëllimi. Shumica e tyre kanë mbetur me infrastrukturë të papërfunduar dhe për pasojë të nën-populluara. Asnjë nga zonat aktuale, as ato që janë më funksionale, nuk kanë njësi brenda tyre që merret me menaxhimin dhe administrimin e tyre. Në disa raste ka edhe përzierje të kompetencave sa i takon pronësisë së tyre.

Shumica dërmuese e komunave nuk posedojnë materiale promovuese që ofrojnë informata mbi potencialet dhe mundësitë për të investuar. Për më shumë, vetëm 23% e komunave kanë zyra apo njësi që merren ekskluzivisht me promovim të mundësive për investimeve.⁵ Kësisoj, investitorët potencial shpeshherë nuk kanë qasje në informatat e nevojshme për të ndërmarrë hapa drejt investimit.

Bujqësia është qenësore për zhvillim rural dhe luan një rol mjaft të rëndësishëm në ekonominë lokale. Ndonëse komunat ofrojnë mbështetje për zhvillim të bujqësisë, kjo mbështetje mbetet e pamjaftueshme për t'i adresuar disa nga problemet parësore të këtij sektori, siç janë: fermat e vogla, teknologjia dhe mjetet e vjetruara të punës, kostot e larta të inputeve bujqësore, si dhe integrimi i kufizuar në industri të

³ Oda Ekonomike e Kosovës (2019). Hapja e rrugës për biznes më të mirë në Kosovë. Qasja: https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2019/June/28/Studimi_Bottleneck_2018_r1561707631.pdf

⁴ MAPL (2021). Studimi i gjithëpërfshirës së sistemit të vetqeverisjes lokale në Kosovë. Qasja: MAPL

⁵ Instituti Riinvest (2020). Indeksi i Konkurruesmërisë së Komunave. Qasja: https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2020/September/14/10_-_MCI_Index_2020_-_ALB_-_02_11600096544.pdf

ushqimit. Turizmi, si sektor tjetër me rëndësi, veçanërisht turizmi rural apo agroturizmi, përkundër potencialit që ka, nuk është zhvilluar sa duhet. Atraksionet turistike, përkatësisht monumentet e trashëgimisë kulturore, pak vihen në funksion të promovimit të ekonomisë kreative. Zejtarët lokalë, si akterë të rëndësishëm identitar të komunave, po ballafaqohen me vështirësi të theksuara në aspekt të qëndrueshmërisë financiare.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), në përgjithësi, kanë nevojë për përkrahje për të ndjekur trendin e vendeve tjera. Ato kanë ngecur sidomos në aspekt të digjitalizimit dhe inovacionit, si në nivel të produkteve ashtu edhe të proceseve. Të dhënat e fundit nga ndërmarrjet prodhuese, për shembull, tregojnë se niveli i digjitalizimit është sa gjysma e nivelit tek ndërmarrjet homologe në Bashkimin Evropian (BE).⁶ Situata e ngjashme është edhe te inovacioni. Vetëm 36.6% e ndërmarrjeve prodhuese deklarojnë se kanë prezantuar një produkt/shërbim të ri ose një risi në procese.⁷ Kjo përqindje është afërsisht sa gjysma e mesatares në Ballkanin Perëndimor (PB). Në kryeqytet dhe në disa komuna tjera janë hapur qendra të inovacionit (apo “hubs”) për t’u shërbyer ndërmarrjeve, sidomos atyre të reja, në jetësimin e ideve inovative. Duke përjashtuar kryeqytetin, ato që operojnë në komunat tjera nuk shquhen për modele të qëndrueshme të financimit dhe kanë vështirësi të shërbejnë si inkubatorë tipik të inovacionit.

Tek sektori privat dhe palët që merren me zhvillim ekonomik lokal ekziston një nivel i ulët i vetëdijes mbi ekonominë qarkore dhe përparësitë që sjellë kjo qasje në aspekt ekonomik dhe në kontekst të ruajtjes së burimeve natyrore dhe përgjithësisht mjedisit. Kur mungojnë informacionet, situata në terren nuk mund të jetë më e mirë. Ndonëse riciklimi konsiderohet element integral i ekonomisë qarkore, në komuna nuk ka infrastrukturë të etabluar mirë për riciklim. Ndarja e mbeturinave, në masë të madhe, bëhet në mënyrë jo formale dhe materiali riciklues kryesisht eksportohet pa u përpunuar. Vlerësohet se një përqindje e vogël ndërmarrjeve shfrytëzojnë material të riciklueshëm. Aspektet e ekonomisë qarkore si ripërdorimi i materialit, mundësitë për riparim dhe përgjithësisht funksionimi në lak të mbyllur kanë zënë shumë pak vend në praktikat biznesore.

Në tregun e punës ekziston një mungesë e theksuar e shkathtësive për t’i përmbushur nevojat e sektorit privat. Përderisa në të kaluarën, ndër sfidat kryesore të bizneseve ka qenë gjetja e fuqisë punëtore të kualifikuar, në vitet e fundit, veç kësaj, bizneset po hasin gjithnjë e më shumë vështirësi në gjetjen e profileve me shkathtësi të ulëta. Shkak kryesor për këtë janë tendencat migruese të kësaj kategorie, qoftë jashtë Kosovës apo nga komunat e vogla drejt komunave të mëdha, kryesisht drejt kryeqytetit. Në hulumtimin e zhvilluar me drejtorë (ose përfaqësues tjerë) të zhvillimit ekonomik në nivel komunal dhe në atë me biznese, kategoria “*vështirësitë në gjetjen e punëtorëve*”, është renditur si pengesa e parë, respektivisht e dyta më seriozja për zhvillimin ekonomik lokal. Gjithashtu, mbi 85% e të njëjtëve vlerësojnë së migrimi është problem i madh ose shumë i madh për komunat e tyre. Në komuna më të vogla, kjo përqindje është edhe më e lartë. Problemet me tregun e punës konfirmohen edhe në burime tjera

⁶ Instituti Riinvest dhe OEGJK (2022). “Kapacitetet Digjitale në sektorin e prodhimit në Kosovë”. Qasja: https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2022/October/19/Digital_capacities_in_manufacturing_sector_in_Kosovo_Riinvest1666185819.pdf

⁷ Banka Botërore (2019). “Enterprise Survey”. Qasja: <https://www.enterprisesurveys.org/content/dam/enterprisesurveys/documents/country/Kosovo-2019.pdf>

hulumtuese. Një hulumtim i OEK, për shembull, tregon se 82.4% e ndërmarrjeve në Kosovë e kanë të vështirë të gjejnë punëtorë të kualifikuar.⁸

Komunat nuk mbledhin të dhëna sistematike për t'i identifikuar profilet që nevojiten në tregun e tyre. Sipas anketës me biznese, disa nga profilet të cilat mungojnë më së shumti janë salduesit, inxhinierët softuerik me përvojë, operatorët e pajisjeve dhe axhustatorët. Bashkëpunimi në mes të sektorit privat dhe shkollave profesionale apo qendrave të akredituara të trajnimit është në nivel të kufizuar. Mungojnë mekanizmat funksionalë që u krijojnë mundësi bizneseve të ofrojnë ndihmën e tyre në hartimin e standardeve të profesionit për shkollim/aftësim profesional. Në anën tjetër, bizneset shumë pak shfaqin interesim për të ofruar mundësi për përvojë praktike në vend të punës. OEK nxjerr në pah se 61.6% e ndërmarrjeve nuk bashkëpunojnë fare me fakultete, shkolla profesionale, qendra trajnuese apo qendra të punësimit.⁹ Për më shumë, firmat rrallë ofrojnë trajnime për punëtorët e tyre. Në sektorin e prodhimit, sipas Bankës Botërore (BB), vetëm 26% të punëtorëve u ofrohet trajnim – pra, trajnimi në punë mungon në shumicën e rasteve.¹⁰ Një problem tjetër është se tek moshat më të vjetra ekziston hendek i theksuar në shkathtësi digjitale. Këto shkathtësi po bëhen të nevojshme çdo here e më shumë.

Në sektorët që janë më të cenueshëm ndaj aksidenteve në punë nuk ofrohet siguri e mjaftueshme. Sipas të dhënave të Inspektoratit të Punës, janë evidentuar 188 aksidente në vend të punës – 9 prej tyre kanë përfunduar me fatalitet.¹¹ Ndërtimtaria mbetet sektori më i rrezikuar në këtë drejtim. Informaliteti në treg të punës mbetet mjaft i lartë. Sipas vlerësimeve të fundit të ASK-së, punësimi joformal është rreth 35%.¹² Një problem tjetër shqetësues është se ekziston një nivel i ulët i integritetit të grave në tregun e punës. Konkretisht, vetëm 20% e tyre marrin pjesë në tregun të punës.¹³ Ky fenomen është ende më i theksuar në profesione të cilat tradicionalisht u kanë takuar burrave.

Ndonëse një pjese e madhe e buxhetit të komunave investohet në infrastrukturë, sidomos në infrastrukturë rrugore (rreth 27%), nuk duket që të ketë krijuar ndikim të mjaftueshëm. Sipas një ankete të realizuar me qytetarë, për nevoja të “Studimit gjithëpërfshirës së sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë”, përgjithësisht ekzistojnë pakënaqësi në lidhje me furnizimin me ujën e pijshëm, menaxhimin e mbeturinave, transportin lokal, infrastrukturën rrugore, kanalizimin dhe trajtimin e ujërave të zeza.¹⁴

Kur vjen puna te financat lokale, komunat i mbulojnë shpenzimet e tyre nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Sasia e mjeteve që alokohet tek komunat nga niveli qendror përmes grantit të përgjithshëm dhe granteve tjera përcjellëse, në raport me të hyrat që ka vendi, konsiderohet relativisht e kënaqshme. Megjithatë, mënyra e shpërndarjes përmes granteve, duke e anashkaluar ndërlidhjen e

⁸ Oda Ekonomike e Kosoves (2018). Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar – sidë për bizneset. Qasja: https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2018/January/26/Mungesa_e_fuqise_punetore_te_kualifikuar_-_sfide_per_bizneset1516952028.pdf

⁹ Ibid.

¹⁰ Banka Botërore (2019). “Enterprise Survey”. Qasja: <https://www.enterprisesurveys.org/content/dam/enterprisesurveys/documents/country/Kosovo-2019.pdf>

¹¹ Inspektorati i Punës (2022). Raporti i punës për 2021. Qasja: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>

¹² Agjencia e Statistikave të Kosovës. ASK Data.

¹³ Ibid.

¹⁴ MAPL (2021). Studimit gjithëpërfshirës së sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Qasja: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/01/STUDIMI-GJITHEPERFSHIRESI-SISTEMIT-TE-VETQEVERISJES-LOKALE-NE-KOSOVE.pdf>

drejtpërdrejtë me të hyrat nga disa lloje të tatimeve (psh. tatimi në të ardhura personale), nuk vlerësohet mënyra më e përshtatshme dhe dallon nga praktikat në vendet e ngjashme në rajon dhe më tej. Për më tepër, ndarja e granteve qeveritare në formë lineare ka bërë që komunat të mos jenë shumë aktive në realizimin e të hyrave vetanake dhe të mos zhvillojnë një lloj konkurrence ndërmjet veti në këtë drejtim.

Në anën tjetër, kompetencat që u janë lënë komunave për të krijuar të hyra nga burimet vetanake (tatimi në pronë, taksat, tarifat dhe ngarkesat tjera komunale) janë të pamjaftueshme për t'i bërë ato të vetëqëndrueshme financiarisht. Pjesa më e madhe e komunave nuk arrijnë t'i mbulojnë më shumë se 15% apo 20% të shpenzimeve nga të hyrat që i arkëtojnë nga burimet vetanake.¹⁵ Vlen të theksohet se veçanërisht komunat e vogla grumbullojnë pak të hyra vetanake dhe në masë të madhe varen nga grantet e nivelit qendror. Si rezultat, këto komuna nuk kanë mjete të mjaftueshme për investime në projekte dhe ushtrim të mirëfilltë të kompetencave vetanake. Në përgjithësi, varësia në masë të madhe nga niveli qendror, përkatësisht mungesa e qëndrueshmërisë financiare, nënvizohet si një prej problemeve të mëdha të komunave për zhvillim ekonomik lokal.

Një sfidë tjetër e financave lokale janë borxhet apo të arkëtueshmet. Përderisa tek rasti i tarifave qytetarët obligohen të paguajnë në momentin kur e pranojnë shërbimin nga komuna, e njëjta gjë nuk është edhe tek tatimet. Për këtë arsye, vështirësitë më të mëdha janë të mbledhja e tatimit në pronë. Shumë prej borxheve ndaj komunave janë vjetërsuar. Këto borxhe, nuk mund të mblidhen, mirëpo as nuk mund të falen apo shlyhen, meqë komuna nuk e ka atë kompetencë.

Në bazë të ligjit për financat e pushtetit lokal, lartësia e tarifave komunale duhet të jetë në proporcion me shpenzimet e komunës, për ofrim të një shërbimi të caktuar. Komunat nuk zhvillojnë ndonjë analizë, përmes të cilës matin kostot e shërbimeve të tyre. Në mungesë të një procesi të kostimit, komunat i vendosin në mënyrë arbitrare tarifat në shërbimet që i ofrojnë. Si rezultat, ekzistojnë dallime të mëdha në mes të komunave sa i takon nivelit të tarifave.

Caktimi i kufijve për kategoritë e shpenzimeve nga niveli qendror, përkatësisht Ministria e Financave, Punësimit dhe Transfereve (MFPT), kufizon aftësinë e komunave për ta përdorur buxhetin e tyre në mënyrë të lirë. Bazuar në të dhënat nga komunat, ankesat kryesore vijnë sidomos për kufizimet në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe subvencioneve.

Në shpenzim të buxhetit, mangësi konsiderohet mbikëqyrja e punëve që realizohen nga kontraktorët. Për shembull, kontraktohet kryerja e punëve për ndërtimin e një rruge të caktuar, mirëpo në shumë raste, mungon mbikëqyrja nga komuna gjatë kryerjes së punëve nga kontraktori. Kjo rezulton në cilësi të dobët të punëve të kryera. Tjetër sfidë me mjaft prezencë është numri i madh i kontratave në raport me numrin e vogël të zyrtarëve të prokurimit.

Në përgjithësi, vlerësohet se zhvillimi ekonomik lokal nuk ka qenë ndër prioritet kryesore të komunave. Më pak se gjysma e komunave kanë strategji për zhvillimin ekonomik lokal. Shumica dërrmuese e atyre që kanë strategji (86.7%), raportojnë se e bëjnë monitorimin e strategjive në baza të rregullta. Nga takimi me komuna është kuptuar se, megjithatë, nuk ekziston një kornizë e monitoruese uniforme që e mat realizimin e aktiviteteve dhe ndikimin në objektiva.

Kapacitetet profesionale për zhvillim ekonomik në institucione komunale janë të pamjaftueshme. Sipas UNDP-së, vetëm 21.6% e drejtorëve, shërbyesve civilë dhe asamblistëve vlerësojnë se niveli komunal ka

¹⁵ Ibid.

kapacitete të brendshme për hartimin e strategjive për zhvillimin ekonomik lokal. Gjithashtu, kapacitetet janë të kufizuara edhe kur vjen puna te hartimi i projekteve për të tërhequr fonde nga donatorët e huaj. Shumë komuna kanë mungesë të personelit të kualifikuar në shumë departamente dhe kjo ndikon negativisht në mjedisin e biznesit. Nga ana tjetër, disa komuna janë me staf të tepërt, por që nuk menaxhohen si duhet.

Bashkëpunimi në mes të komunave dhe komunitetit të biznesit vlerësohet të jetë në nivel jo të kënaqshëm. Vetëm një përqindje e vogël e komunave, kryesisht ato që janë më të mëdha, kanë shoqata/organizata biznesi funksionale, të cilat përfaqësojnë dhe ndihmojnë sektorin privat duke i artikuluar nevojat e tyre. Probleme ka edhe në mes të nivelit lokal dhe qendror në lidhje me zhvillimin ekonomik. Paqartësia rreth kompetencave në mes të nivelit lokal dhe atij qendror është renditur si barriera më serioze në anketën e zhvilluar me komuna. Bashkëpunimi ndër-komunal, në anën tjetër, është kryesisht në projekte investuese infrastrukturore. Komunitetet deklarojnë se gjysma e tyre kanë projekte të përbashkëta, ku përfshihen asfaltimi i rrugëve, hapja dhe definimi i shtigjeve për qëllime turistike, rregullimi i shtretërve të lumit dhe të ngjashme.

6. Ndërlidhja me dokumentet strategjike relevante

Strategjia dhe plani kombëtar për zhvillim (SKZH dhe PKZH 2030) është dokumenti kryesor strategjik i vendit në perspektivë afatgjatë. Duke qenë se është në krye të hierarkisë së dokumenteve strategjike, të gjitha dokumentet tjera të kësaj natyre, përfshirë edhe këtë program, duhet të jenë të ankoruara në të.

SKZH dhe PKZH 2030 organizohet në katër shtylla, të cilat janë: (I) Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; (II) Zhvillimi i barabartë njerëzor; (III) Siguria dhe sundimi i ligjit; dhe (IV) Qeverisja e mirë. Shtylla e parë, siç tregon edhe emri, është ajo në të cilën kryesisht është bazuar PNZHEL 2030. Te kjo shtyllë, synohen të arrihen tri qëllime kryesore. Qëllimi i parë ka të bëjë me krijimin e një ekonomie digjitale, qarkore dhe konkurruese. Për ta arritur këtë qëllim, parashihet përmirësimi i mjedisit biznesor dhe transformimi ekonomisë drejt aktiviteteve me vlerë të shtuar, me fokus në digjitalizim e inovacion. Qëllimi i dytë është që infrastruktura të jetë cilësore, e qëndrueshme dhe e integruar. Në këtë kuadër, parashihet që të përmirësohet infrastruktura dhe shërbimet e transportit, sidomos transportit hekurudhor; të ketë furnizim të qëndrueshëm dhe të përballueshëm me energji; dhe të avancohet infrastruktura komunikimit, që është qenësore për digjitalizim. Qëllimi i fundit në këtë shtyllë, por jo më pak i rëndësishmi, është që mjedisi të jetë i pastër, pra të parandalohet ndotja e tokës, ujit dhe ajrit dhe të mbrohet biodiversiteti në përgjithësi, ndërkohë që burimet natyrore të shfrytëzohen në mënyre efikase.

Shtylla e dytë, përkatësisht qëllimi i parë i kësaj shtylle – krijimi i një tregu gjithëpërfshirës të punës me punësim të lartë dhe të denjë, lidhet me fushëveprimin e PNZHEL 2030. Ky qëllim parashihet të arrihet përmes zhvillimit të shkathtësive dhe kompetencave, si dhe ngushtimit të hendekut në tregun e punës; rritjes së pjesëmarrjes së grave në tregun e punës; dhe përmirësimin të kushteve të punës.

Përpos shtyllave me qëllime dhe objektiva përkatëse, në SKZH dhe PKZH 2030, gjithashtu janë të përcaktuara agjendat horizontale, si çështjet apo fushat që kërkojnë koordinim midis shumë sektorëve. Agjenda digjitale, gjithëpërfshirja, agjenda e gjelbër, migrimi dhe diaspora përbëjnë agjendat horizontale të SKZH dhe PKZH 2030. Të gjitha këto janë dimensione shtesë, të cilat janë marrë parasysh në PNZHEL 2030.

Strategjia për vetëqeverisjen lokale (2016-2026) është dokument që përcakton kornizën strategjike bazë për avancimin e vetëqeverisjes lokale. Kjo strategji shërben si instrument kryesor për udhëzimin e zhvillimit të politikave, strategjive dhe planeve zhvillimore socio-ekonomike në nivel lokal dhe njëkohësisht bën ndërlidhjen me kornizën strategjike të nivelit qendror të përcaktuar me dokumentet strategjike të asaj kohe. Objektivi i parë e kësaj strategjie, rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale të komunave, ka qenë më relevantja për nevojat e këtij programi. Për ta përmbushur objektivin në fjalë është paraparë që, mes tjerash, të bëhet ndryshimi i bazës ligjore për financimin e komunave; të përmirësohet infrastruktura e rrugëve lokale dhe rrjetit të transportit ndër-urban; të aftësohen të rinjtë dhe të përgatiten për treg të punës; të mbështeten bizneset; dhe të zhvillohet sektori i bujqësisë. Dy objektiva tjera të strategjisë, të cilat gjithashtu ndërlidhen me fushëveprimin e këtij programi, por në formë më të përgjithshme, janë: (a) forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave dhe (b) forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve. Në të parën nga këto dy objektiva parashihet krijimi i një sistemi të avancuar për edukim të vazhdueshëm profesional për zyrtarët komunalë, ndryshimi i sjelljes së punëtorëve përmes vlerësimit të performancës, zhvillimi i kapaciteteve lokale për monitorim të punëve që dalin nga partneriteti me bizneset dhe masa të tjera të ngjashme. Ndërkaq, për ta përmbushur objektivin tjetër, si masa që lidhen me programin janë inicimi i

programeve të praktikës për nxënësit e shkollave të mesme dhe bashkëpunimi për të mbështetur ndërmarrësit e rinj.

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal (2019-2023) është dokumenti strategjik në fuqi që përcakton rrugën për zhvillim ekonomik lokal të komunave. Meqenëse ky dokument skadon në 2023-ën, pritet që PNZHEL të jetë vazhdimësi e kësaj strategjie. Fushëveprimi i këtij dokumenti, ndonëse vetëm te pjesa e analizës, shkon përtej kuptimit tipik të konceptit të zhvillimit ekonomik, duke trajtuar edhe fusha tjera (si p.sh. shëndetësinë), që vetëm tërthorazi lidhen me temën. Kjo strategji përmban katër objektiva strategjike: rritja e qëndrueshmërisë financiare të komunave; tërheqja e investimeve të huaja; fuqizimi i ekonomisë lokale përmes investimit në kapitalin njerëzor; shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Për ta përmbushur rritjen e qëndrueshmërisë financiare, është paraparë që të zvogëlohet varësia buxhetore e komunave nga niveli qendror, krijimi i mekanizmit të veçantë për koordinimin e procesit të financimit të investimeve nga niveli qendror në nivelin lokal dhe krijimi i mundësisë për huamarrje. Të gjitha këto, përkundër faktit që janë shumë të rëndësishme për qëndrueshmërinë e financave lokale, realizimi i tyre më shumë lidhet me kompetencat e nivelit qendror. Sidoqoftë, raporti i fundit monitorues për zbatimin e kësaj strategjie tregon se janë bërë përpjekje të vazhdueshme për ta përmirësuar qëndrueshmërinë e komunave dhe politikat që nxisin zhvillimin e mëtejshëm. Sipas këtij raporti, deri në të 2022-ën, 38.5% e aktiviteteve që ndërlidhen me qëndrueshmërinë financiare janë zbatuar plotësisht, ndërsa 38.5% të tjera janë zbatuar vetëm pjesërisht.

Objektivi strategjik për tërheqje të investimeve të huaja është paraparë të arrihet duke krijuar kushte të favorshme për investitorët, duke funksionalizuar plotësisht zonat e lira ekonomike dhe duke rritur transparencën për investime të huaja. Tërheqja e investimeve është gjithashtu objektivi i SKZH-së dhe PKZH-së, ndonëse në atë rast, investimet nuk reduktohet vetëm në investime të huaja direkte, por trajtohen pa dallim me investimet vendore. Në këtë rast, janë përmbushur më shumë aktivitete krahasuar me objektivin e qëndrueshmërisë financiare. Konkretisht, 43% e aktiviteteve janë përmbushur plotësisht, ndërsa 42.8 pjesërisht.

Fuqizimi i ekonomisë lokale përmes kapitalit njerëzor është paraparë të arrihet duke e zhvilluar arsimin profesional. Ky është një aspekt i rëndësishëm për adresimin e mungesës së shkathtësive të duhura në tregun e punës. Fokusi është vendosur tek ky dimension i adresimit të çështjes, duke qenë se komunat kanë më shumë kompetenca në këtë drejtim. Kjo vërehet edhe në raportin e fundit të monitorimit, ku 53.4% e aktiviteteve janë zbatuar plotësisht dhe 32.2% pjesërisht.

Shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit ekonomik, si objektivi strategjik, është paraparë të arrihet përmes përmirësimit të kushteve për zhvillim të turizmit, krijimit të bazës ligjore për subvencionim të kamatave dhe përmirësimit të infrastrukturës në funksion të bizneseve. Edhe pse të gjitha objektivat specifike janë të rëndësishme, ato nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt me objektivin strategjik. Për më shumë, aktivitetet e planifikuara janë zbatuar më së paku krahasuar me aktivitetet e objektivave tjera. Më saktësisht, vetëm 34.4% e aktiviteteve janë zbatuar plotësisht. Ndërsa, shumica (55.4%) janë zbatuar pjesërisht.

7. Vizioni, objektivat dhe masat

PROGRAMI NACIONAL PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL

Krijimi i një ekonomie lokale të qëndrueshme, të larmishme dhe të përshtatshme ndaj ndryshimeve, që sjell zhvillim dhe prosperitet për të gjithë.

1. Ekonomi lokale konkurruese

1.1. Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal

1.2. Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal

1.3. Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion

2. Punësim gjithëpërfshirës

2.1. Zvogëlimi i hendekut të shkathtësive në tregun e punës

2.2. Rritja e punësimit të dinjitetshëm për gra, të rinj dhe kategori të cënueshme

3. Infrastrukturë lokale e përmirësuar

3.1. Përmirësimi infrastrukturës së transportit lokal dhe shërbimeve

3.2. Sigurimi i qasjes në infrastrukturë përcjellëse

3.3. Menaxhimi i integruar i mbeturinave

3.4. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në infrastrukturë

4. Qeverisje ekonomike efektive dhe bashkëpunuese

4.1. Financa lokale të qëndrueshme dhe efektive

4.2. Avancimi i proceseve dhe resurseve në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale

4.3. Përmirësimi i shërbimit dhe përgjegjshmërisë komunale

4.4. Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal

Vizioni: Krijimi i një ekonomie lokale të qëndrueshme, të larmishme dhe të përshtatshme ndaj ndryshimeve, që sjell zhvillim dhe prosperitet për të gjithë.

- ✓ *Ekonomi lokale e qëndrueshme* që promovon efikasitetin, barazinë sociale dhe përgjegjësinë ndaj mjedisit;
- ✓ *Ekonomi lokale e larmishme* që synon të arrijë një kombinim apo konfiguracion industrish që e zvogëlojnë ndikimin në rast të luhatjeve në segmente të caktuara të ekonomisë;
- ✓ *Ekonomi lokale e përshtatshme ndaj ndryshimeve* që krijon një infrastrukturë të adaptueshme dhe sistem fleksibil ndaj ndryshimeve dhe dinamikave apo trendeve ekonomike.

Objektivi 1: Ekonomi lokale konkurruese

Krijimi i një ekonomie lokale konkurruese përbën një aspekt qenësor të zhvillimit. Mjedisi konkurrues inkurajon investime të reja në sektorë produktivë dhe nxit krijimin e vendeve cilësore të punës. Ndonëse përgjatë viteve, ekonomitë lokale kanë shënuar progres në përmirësimin e konkurrueshmërisë së tyre, ato ende ballafaqohen me mungesë të investimeve në veprimtari ekonomike me vlerë të shtuar, kanë produktivitet relativisht të ulët dhe kanë ngelur prapa sa i përket trendeve globale të digjitalizimit dhe inovacionit. Për ta krijuar një ekonomi lokale konkurruese, PNZHEL 2030 parasheh që të rriten investimet në fushat me potencial për zhvillim ekonomik, të rritet produktiviteti në bujqësi dhe të promovohet turizmi lokal, si dhe të përkrahët ndërmarrësia.

Ky objektivi ndërlidhet me Qëllimin I të SKZH-së dhe PKZH-së për të krijuar një ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Strategjinë për zhvillimin e industrisë dhe mbështetjen e bizneseve, Strategjinë për ndërmarrësi dhe inovacion, si dhe me Strategjinë për bujqësi dhe zhvillim rural. Përbushja e këtij objektivi do të ndikojë drejtpërdrejt në arritjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG), përkatësisht Objektivin 8 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike), Objektivin 9 (Industri, inovacion dhe infrastrukturë) dhe Objektivin 12 (Konsum dhe prodhim i përgjithshëm).

Objektivi specifik 1.1: Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal

Mobilizimi i investimeve, qoftë vendore apo të huaja, është i rëndësishëm për rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë së komunave. Investimet e balancuara gjeografikisht i kontribuojnë qasjes gjithëpërfshirëse të zhvillimit dhe bëjnë që asnjë komunë të mos ngelet prapa. Për të rritur investimet në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal, PNZHEL 2030 parasheh që komunat të angazhohen në promovim të investimeve, duke hartuar profile ekonomike dhe materiale tjera promovuese, ku shfaqen potencialet për investime konform karakteristikave të zonave. Përpos kësaj, është e domosdoshme që të ketë ngritje të resurseve njerëzore brenda komunave për të siguruar promovim sistematik të investimeve, si dhe për të përmirësuar qasjen në fonde zhvillimore. Lirimi nga tatimi në pronë do të mund të shfrytëzohet si një instrument fiskal për t'i stimuluar investimet e natyrës më strategjike. Fjala është për investime të cilat kanë vlerë më të lartë dhe potencial për të krijuar më shumë vende të punës. Pronat të cilat janë në pronësi të komunës, do të klasifikohen më mirë, që të dihet se cilat nga ato mund të shfrytëzohen për të përkrahur investimet. Gjithashtu, ekzistojnë prona nën menaxhimin e AKP-së, të cilat mund të kalojnë nën menaxhim të komunave dhe të shfrytëzohen për nxitje të investimeve, porse është e nevojshme që të thjeshtohen procedurat për bartje të menaxhimit nga AKP-ja te komunat. Komunave do t'u sigurohet mundësi që të ofrojnë garanci kreditore për ndërmarrjet, ashtu që ta përmirësojnë qasjen

e tyre në financa. Krijimi i parqeve industriale të specializuara me veçori miqësore për mjedisin, gjithashtu duhet të jetë në mesin e prioriteteve të komunave për nxitje të investimeve.

Ky objektivi specifik lidhet me Objektivin 1.6 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon rritjen e investimeve të orientuara në eksport.

Të bëhet:

- *Hartimi i profileve ekonomike dhe materialeve të tjera promovuese të komunave ku tregohen potencialet për investime*
- *Ngritja e resurseve njerëzore brenda komunave për t'i promovuar investimet*
- *Ngritja e kapaciteteve komunale për qasje në fondeve zhvillimore*
- *Lehtësira të tatimit në pronë për stimulim të investimeve të natyrës më strategjike*
- *Klasifikimi më i mirë i pronës komunale për dhënie në shfrytëzim*
- *Thjeshtimi i procedurave për kalim të pronës nga AKP-ja te komunat*
- *Thjeshtimi i procedurave për promovimin e iniciativave të partneritetit publiko privat*
- *Krijimi i mundësisë që komunat të ofrojnë garanci kreditore për ndërmarrjet, ashtu që të përmirësohet qasja e tyre në financa*
- *Krijimi i parqeve industriale të specializuara me veçori miqësore për mjedisin*

Objektivi specifik 1.2: Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal

Bujqësia dhe turizmi janë sektorë me interes vital për zhvillim lokal të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Të dy këta sektorë ndihmojnë ndjeshëm në krijimin e të ardhurave dhe vendeve të reja të punës, sidomos tek shtresat shoqërore më të cenueshme. Për të kontribuar në përmirësim të produktivitetit në bujqësi, është e nevojshme të rritet përkrahja përmes granteve për blerje të pajisjeve moderne. Duke qenë se paralizimi i tokave paraqet problem për ta ushtruar veprimtarinë në mënyrë të leverdishme, të njëjtat grante mund të përmbajnë kushte që e inkurajojnë bashkimin e parcelave. Krahas granteve, është e nevojshme të rritet edhe përkrahja në formë të subvencioneve, si dhe të punohet në thjeshtim të procedurave për aplikim. Si të grantet ashtu dhe të subvencionet, përkrahjes së grave duhet t'u kushtohet vëmendje të veçantë. Për më shumë, është e nevojshme të mbështetet formimi i kooperativave bujqësore moderne, duke u dhënë përparësi grave pronare. Zyrat këshilluese brenda komunave, duhet të fuqizohen për t'i ndihmuar më shumë fermerët lidhur me proceset e aplikimit për grante. Më tutje, është e nevojshme të ofrohen trajnime për fermerët që t'iu ngritën aftësitë për kultivim më efikas të prodhimeve bujqësore. Njëkohësisht, avancimi i zinxhirëve të vlerës përmes pikave grumbulluese dhe formave bashkëpunuese duhet të jetë në mesin e prioriteteve të bujqësisë. Për ta promovuar turizmin, komunat duhet të punojnë në zhvillim të brendit të tyre turistik, ku përfshihet logoja, slogani, identiteti vizual dhe në përgjithësi narracioni turistik. Në këtë drejtim, themelimi dhe funksionalizimi i qendrave informative është gjithashtu i rëndësishëm për komunikim të ofertës turistike. Infrastruktura turistike, si për shembull qasja në destinacione, sinjalistika dhe të ngjashmet kanë nevojë për rregullim. Shumë hapësira të trashëgimisë kulturore nën menaxhim lokal kanë nevojë të restaurohen dhe rimodelohen, ashtu që, veç tjerash, t'i shërbejnë ekonomisë kreative. Në fund, por jo me më pak rëndësi, nevojitet përkrahje për zhvillimin e produkteve që promovojnë agroturizmin.

Ky objektiv specifik lidhet me Objektivin 1.7 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon përmirësimin e produktivitetit dhe qëndrueshmërisë në bujqësi. Turizmi nuk trajtohet si objektiv i veçantë të SKZH-ja dhe PKZH-ja, por hyn në kuadër të Objektivit 1.3, që synon të krijojë produkte dhe shërbime me vlerë të shtuar.

Të bëhet:

- *Ofrimi i granteve për pajisje në bujqësi me kusht bashkimin e parcelave*
- *Rritja e subvencionimit direkt në bujqësi me procedura më të thjeshtuara*
- *Ofrimi i mbështetjes për formimin e kooperativave bujqësore moderne me fokus të veçantë për gratë pronare*
- *Fuqizimi i zyrave këshilluese për t'i ndihmuar fermerët në proces të aplikimit për grante*
- *Trajnime për fermerët për ngritje të aftësive për kultivim më efikas të prodhimeve bujqësore*
- *Përmirësimi i zinxhirit të vlerës në bujqësi përmes përkrahjes së pikave grumbulluese*
- *Brendimi turistik i komunave (logoja, slogani, identiteti vizual dhe narracioni turistik në përgjithësi)*
- *Krijimi dhe funksionalizimi i qendrave informative për promovimin e turizmit lokal*
- *Përmirësimi i infrastrukturës lokale në zonat turistike*
- *Restaurimi i hapësirave të trashëgimisë kulturore dhe rimodelimi i tyre për ta promovuar ekonominë kreative*

Objektivi specifik 1.3: Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion

Në kohët e sotme, shtytësit kryesorë të rritjes dhe zhvillimit të NVM-ve dhe krijimit të startup bizneseve janë digjitalizimi dhe inovacioni. Përsheptimi i tranzicionit me fokus në digjitalizim dhe inovacion është parakusht për krijimin e një ekonomie lokale konkurruese. Për t'u arritur ky objektiv specifik, është e nevojshme të ofrohet mbështetje për themelimin e qendrave të inovacionit të specializuara në veprimtari të zonës. Gjithashtu, nevojitet përkrahje për trajnime rreth përparësive të digjitalizimit të proceseve dhe dobisë së ekonomisë qarkore, mbështetje direkte për inovacion, si dhe organizim ngjarjesh ku promovohen dhe shpërblehen ndërmarrjet lokale inovative.

Ky objektiv specifik ndërlidhet me Objektivin 1.3 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon përsheptimin i transformimit digjital dhe inovacionit tek NVM-të dhe startup bizneset.

Të bëhet:

- *Ofrimi i mbështetjes për themelimin e qendrave të inovacionit të specializuara në veprimtari të zonës*
- *Mbështetja e trajnimeve për përparësitë e digjitalizimit të proceseve dhe dobisë së ekonomisë qarkore*
- *Ofrimi i granteve për ndërmarrje të reja inovative (ndërmarrjeve në pronësi të grave t'u jepet përparësi)*
- *Ofrimi i shpërblimeve vjetore për ndërmarrjet lokale më inovative*

Objektivi 2: Punësim gjithëpërfshirës

Rritja e punësimit dhe krijimi i kushteve për punë dinjitoze për të gjithë janë aspekte të rëndësishme zhvillimore. Punësimi cilësor ndikon në krijim të mirëqenies dhe zvogëlim të pabarazive në shoqëri. Për më tepër, punësimi është shumë i rëndësishëm për t'i parandaluar tendencat për migrim, sidomos në komuna të vogla. Përkundër faktit që në vitet e fundit është shënuar rritje në punësim, prapëseprapë norma e përgjithshme e punësimit mbetet ende mjaftë e ulët, sidomos tek gratë dhe të rinjtë. Përpos problemeve strukturore ekonomike që ndikojnë në punësim, një problem i vazhdueshëm mbetet hendeku i theksuar në mes të ofertës dhe kërkesës në tregun e punës. Për ta adresuar çështjen e punësimit, PNZHEL 2030 synon të zvogëlojë hendekun e shkathtësive në tregun e punës dhe të rrisë punësimin e dinjitetshëm për gra, të rinj dhe grupe të cënueshme.

Ky objektivi lidhet me Qëllimin 5 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon të krijojë një treg gjithëpërfshirës të punës, të lartë dhe të denjë, me Strategjinë për punësim dhe treg të punës, dhe me Strategjinë për arsim. Ky objektivi ka më së shumti kontribut në arritjen e SDG 8 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike).

Objektivi specifik 2.1: Zvogëlimi i hendekut të shkathtësive në tregun e punës

Ndonëse norma e papunësisë është mjaft e lartë, punëdhënësit vazhdimisht ankohen se hasin në vështirësi në gjetjen e profileve të duhura për përmbushje të nevojave të tyre. Në këtë kontekst, përgatitja e fuqisë punëtore që t'i përshtaten kërkesave të tregut është tejet e rëndësishme për krijim të vendeve të reja të punës. Për t'u arritur kjo, është e nevojshme që fillimisht të krijohen këshille komunale apo platforma të ngjashme, të cilat mundësojnë identifikimin dhe artikullimin e nevojave të sektorit privat në lidhje me shkathtësitë që mungojnë në treg të punës. Gjithashtu, zyrat e punësimit, të cilat janë prezente nëpër komuna, duhet të fuqizohen. Më tutje, programet dhe kurrikulat në shkolla profesionale dhe qendra të aftësisë profesionale do të përshtaten me nevojat e tregut. Në anën tjetër, komunat duhet të dizajnojnë forma të përkrahjes së trajnimeve në vend të punës ose formave tjera të trajnimeve.

Ky objektivi specifik lidhet me Objektivin 5.1 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon zhvillimin e shkathtësive dhe ngushtimin e hendekut në tregun e punës.

Të bëhet:

- *Krijimi i këshilleve komunale për artikullim të nevojave të sektorit privat*
- *Fuqizimi i zyrave të punësimit*
- *Përshtatja e programeve dhe kurrikulave në shkolla profesionale dhe qendra të aftësisë profesionale me nevojat e tregut*
- *Mbështetja e trajnimeve në vend të punës ose formave tjera të trajnimeve*

Integrimi dhe rritja e punësimit cilësor te gratë, të rinjtë dhe kategoritë e cënueshme, përveçse krijon mirëqenie për ta, i kontribuon edhe zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik. Për t'i kontribuar këtij objektivi specifik, është e nevojshme që gratë, të rinjtë dhe grupet e cënueshme të priorizohen në mundësitë që ofrohen përmes Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP). Diaspora mund të luajë rol shumë qenësor në bartje të dijes dhe rrjedhimisht në përmirësim të mundësive të punësimit. Në këtë drejtim, mund të parashihen programe mentoruese, ku diaspora angazhohet për aftësim të kategorive të sipërpërmendura.

Gjithashtu, në mënyrë që të adresohet hendeku në informacion, duhet të organizohen panairë dhe ngjarje të ngjashme promovuese që i sjellin bashkë punëdhënësit dhe punëkërkuessit, në këtë rast gratë, të rinjtë dhe kategoritë e cenushme. Duke qenë se gratë mbesin jashtë tregut të punës kryesisht për shkak të obligimeve familjare, është e nevojshme që të përmirësohet qasja e konvencionale në kujdes ditor për fëmijë dhe të moshuar, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në treg të punës.

Ky objektivi specifik lidhet pjesërisht me Objektivin 5.2 të SKZH-së dhe PKZH-së, që ka për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Dy kategoritë tjera, përkatësisht të rinjtë dhe grupet e cenushme, lidhen me agjendën horizontale të SKZH-së dhe PKZH-së.

Të bëhet:

- *Mentorimi i të rinjve dhe grave të papuna nga diaspora, për t'iu përmirësuar mundësitë për vetëpunësim*
- *Prioritizimi i grave dhe të rinjve në përkrahjen për punësim përmes MATP*
- *Krijimi i panairëve të punës me fokus punësimin e grave dhe të rinjve*
- *Ofrimi i qasjes së konvencionale në kujdes ditor për fëmijë dhe të moshuar, për të mundësuar qasjen e grave në treg të punës*

Objektivi 3: Infrastrukturë lokale e përmirësuar

Zhvillimi i infrastrukturës lokale, përpos ndikimit në përmirësim të jetës së qytetarëve, luan një rol qenësor edhe në rritje ekonomike, duke e krijuar një mjedis më të lehtë për operim të ndërmarrjeve dhe akterëve tjerë të tregut. Përgjatë viteve, komunat kanë shpenzuar një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të tyre për të investuar në projekte infrastrukturore. Si rezultat, janë shënuar përmirësime të dukshme në këtë fushë. Përkundër progresit, infrastruktura e transportit përgjithësisht mbetet e pakompletuar dhe shërbimet nuk janë në nivel optimal. Për më tepër, ekzistojnë sfida në lidhje me infrastrukturën përcjellëse, si për shembull në lidhje me rrjetin e kanalizimit. Menaxhimi i integruar i mbeturinave është i dobët dhe investimet në efikasitet janë të mangëta. Për ta përmirësuar infrastrukturën lokale, PNZHEL 2030 synon që ta përmirësojë infrastrukturën për transport lokal dhe shërbime, të sigurojë qasje në infrastrukturën përcjellëse, të menaxhojë mbeturinat në mënyrë të integruar dhe të përmirësojë efikasitetin e energjisë.

Ky objektivi lidhet drejtpërdrejt me Qëllimin II të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon të krijojë infrastrukturë cilësore, të integruar dhe të qëndrueshme. Gjithashtu, lidhet me Strategjinë për transportin multimodal, Strategjinë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, Strategjinë e energjisë, Strategjinë për menaxhimin e integruar të mbeturinave.

Objektivi specifik 3.1. Përmirësimi i infrastrukturës së transportit lokal dhe shërbimeve

Infrastruktura dhe shërbimet e transportit janë esenciale për lëvizje të mallrave dhe njerëzve në ekonomi. Investimet në infrastrukturë të transportit stimulojnë ekonominë lokale duke reduktuar kostot e lëvizjes për bizneset dhe qytetarët, si dhe përgjithësisht duke përmirësuar pjesëmarrjen e tyre në treg. Për arritjen e këtij objektivi, duhet të vazhdojë ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruktimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale.

Paralel me këtë, duhet të përmirësohet infrastruktura sinjalistike në komunikacion dhe të krijohen hapësira të reja të parkingut. Njëkohësisht, është e nevojshme që të investohet në zhvillim të transportit alternativ dhe miqësor për mjedisin. Shërbimet e stacioneve të autobusëve duhet të digjitalizohen dhe të organizohet transport publik lokal në komuna më të mëdha.

Ky objektivi specifik lidhet me tri objektiva të SKZH-së dhe PKZH-së: Objektivin 2.3, që synon përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit; Objektivin 2.5, që synon rritjen e sigurisë së transportit; dhe Objektivin 3.6, që ka për qëllim promovimin e mobilitetit digjital dhe të qëndrueshëm.

Të bëhet:

- *Ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruktimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale*
- *Përmirësimi i infrastrukturës sinjalistike në komunikacion*
- *Krijimi i hapësirave të reja të parkingut publik*
- *Digjitalizimi i shërbimeve në stacionet e autobusëve*
- *Përkrahja e investimeve në transport alternativ*
- *Organizimi i transportit publik lokal në komuna më të mëdha (aty ku mungon)*

Objektivi specifik 3.2: Sigurimi i qasjes në infrastrukturë përcjellëse

Infrastruktura e ujit dhe kanalizimit është e rëndësishme për infrastrukturën e nivelit lokal. Përmirësimi i kësaj infrastrukture, duke përfshirë edhe qasjen në të, është parakusht për zhvillim të aktiviteteve ekonomike dhe jo vetëm. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të ndahet më shumë buxhet për rregullimin e rrjetit të kanalizimit dhe drenazhit, si dhe aty ku është e mundur, të ndërtohen impiante për trajtimin e ujërave të zeza.

Në SKZH dhe PKZH nuk ka ndonjë objektivi që lidhet drejtpërdrejt me këtë objektivi specifik, por sidoqoftë kjo i kontribuon Qëllimit II (Infrastrukturë cilësore, të integruar dhe të qëndrueshme).

Të bëhet:

- *Ndarja e më shumë mjeteve financiare për rregullimin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe drenazhit*
- *Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza*

Objektivi specifik 3.3: Menaxhimi i integruar i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave kërkon një qasje të integruar, e cila mundëson reduktimin e tyre, përmirësimin e mbledhjes, riciklimin dhe deponimin e duhur të mbetjeve të gjenerura nga qytetarët, institucionet, bizneset dhe industria. Menaxhimi i integruar i mbeturinave kontribuon drejt një ekonomie qarkore që sjell përfitime ekonomike, duke mbrojtur ambientin dhe shoqërinë. Investimet infrastrukturale që kërkohen për të themeluar një sistem funksional për menaxhim të integruar të mbeturinave janë të larta. Kjo paraqet një mundësi për bashkëpunim ndër-komunal në përputhje me ekonominë e shkallës. Për t'u

arritur kjo objektivë specifike, do të ketë përkrahje nga niveli qendror për ngritjen e kapaciteteve për menaxhim dhe operim të duhur të ndërmarrjeve publike rajonale për menaxhim të mbeturinave. Për të siguruar një planifikim të mirëfilltë të sistemit që i përmbush nevojat e komunave dhe është në përputhje me parimet e ekonomisë qarkore duhet të hartohen planet ndërkomunale për menaxhim të integruar të mbeturinave. Si pjesë e këtyre planeve dhe në përputhje me Strategjinë për menaxhim të integruar të mbeturinave, duhet të zhvillohet infrastruktura e ndarjes dhe grumbullimit të mbeturinave, rrjetet e stacioneve të transferimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave përmes iniciativave dhe bashkëpunimit ndërkomunale. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të krijohen qendra të riciklimit dhe kompozimit të mbeturinave, si dhe paralel me këtë, të rritet vetëdija për dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Përveç këtyre, është e domosdoshme të ofrohen grante për inovacion që promovojnë parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave, me fokus të veçantë në gjetjen e alternativave ndaj ambalazhit dhe produkteve plastike. Për fund, duhet promovohet bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat dhe komunave në trajtim, riciklim dhe ripërdorim të fraksioneve të caktuara të mbeturinave.

Ky objektiv specifik lidhet ngushtë me Objektivin 3.1 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe rritjen e qarkullimit të resurseve.

Të bëhet:

- *Rritja e përkrahjes nga niveli qendror për ngritjen e kapaciteteve për menaxhim dhe operim të mirëfilltë të ndërmarrjeve publike rajonale për menaxhim të mbeturinave*
- *Zhvillimi i planeve ndërkomunale për menaxhim të integruar të mbeturinave*
- *Zhvillimi i rrjetit të stacioneve të transferimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave përmes iniciativave ndër-komunale*
- *Krijimi i qendrave të riciklimit dhe kompozimit të mbeturinave në bazë të analizave të fizibilitetit dhe planeve të integruara*
- *Rritja e vetëdijes për dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave*
- *Ofrimi i granteve për inovacion që e promovojnë parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave, me fokus të veçantë në gjetjen e alternativave ndaj ambalazhit dhe produkteve plastike*
- *Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe komunave në trajtim, riciklim dhe ripërdorim të fraksioneve të caktuara të mbeturinave*

Objektivi specifik 3.4: Përmirësimi i efijencës së energjisë në infrastrukturë

Efiçenca e energjisë është integrale për infrastrukturën. Përveçse kontribuon në ulje të kostove, për ta bërë atë më efiçente, investimi në infrastrukturë ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në mbrojtje të mjedisit. Për ta arritur këtë objektiv është e nevojshme që të bëhet renovimi i të gjitha ndërtesave nën pronësi dhe menaxhim të komunës, të investohet në teknologji LED për ndriçim të rrugëve dhe të ofrohet përkrahje për sektorin privat për përdorimin e paneleve solare në objekte afariste.

Ky objektiv specifik lidhet drejtpërdrejt me Objektivin 3.4 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon përmirësimin e efijencës së energjisë.

Të bëhet:

- *Renovimi i ndërtesave publike komunale, për ta përmirësuar efijencën e tyre*
- *Rehabilitimi i ndriçimit të rrugëve me teknologji LED*
- *Ofrimi i stimujve për përdorimin e paneleve solare në objekte afariste*

Objektivi 4: Qeverisje ekonomike efektive dhe bashkëpunuese

Qeverisja efektive dhe bashkëpunimi janë parakushte për zhvillim ekonomik lokal të qëndrueshëm. Në vitet e fundit janë vërejtur përmirësime në parametra të qeverisjes së mirë. Pavarësisht kësaj, ka hapësirë për progres të mëtutjeshëm në adresimin e çështjeve që lidhen me financat lokale, resurset planifikuese, shërbimet publike, dhe nivelin e bashkëpunimit. Për të ta përbushur këtë objektivi, PNZHEL parasheh që financat lokale të bëhen të qëndrueshme dhe efektive, të avancohen proceset dhe resurset në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale, të përmirësohen shërbimi dhe përgjegjshmëria lokale dhe të rritet partneriteti për zhvillim ekonomik lokal.

Ky objektivi lidhet në masë të madhe me Qëllimin X të SKZH-së dhe PKZH-së, për të krijuar qeveri efektive dhe llogaridhënëse. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Strategjinë për reformën e menaxhimit të financave publike, Strategjinë për reformën e administratës publike dhe Strategjinë për vetëqeverisje lokale.

Objektivi specifik 4.1: Financa të pushtetit lokal të qëndrueshme dhe efektive

Arritja e qëndrueshmërisë në financat e pushtetit lokal është thelbësore për realizimin e masave që nevojiten për zhvillim ekonomik lokal dhe për një qeverisje efektive në përgjithësi. Për të arritur këtë objektivi specifik, fillimisht do të rishikohen kushtet dhe kriteret për të përcaktuar banorët rezidentë në komunë që të ketë ndarje më të mirë të fondeve qeveritare. Njëkohësisht, do të rishikohen politikat buxhetore për grantet specifike bazuar në kompetenca, që të ketë menaxhim më të mirë të financave. Për më shumë, duhet të avancohet buxheti i përgjegjshëm buxhetor. Në këtë drejtim, mes tjerash, është e nevojshme të përmirësohet cilësia e të dhënave të përfituesve të nivelit lokal gra sipas gjinisë, si parakusht i mirë-planifikimit. Fleksibilitet më shumë do të ketë në shpenzime operative. Për të rritur gamën e të hyrave vetanake, duhen paraparë tarifa apo taksa shesë, si për shembull për mbrojtje të mjedisit, për shit-blerje të patundshmërive apo për raste të trashëgimisë. Paralel më këtë, do të krijohen mekanizma për grumbullim më të mirë dhe efektiv të llogarive të arkëtueshme, duke zvogëluar kështu borxhet ndaj komunave. Përveç kësaj, duhet të organizohen fushata vetëdijësuese për rritjen e shkalles së inkasimit të të hyrave vetanake, duke shpjeguar në mënyrë vizuale lidhjen midis inkasimit dhe ndikimit në zhvillim ekonomik lokal. Krijimi i kushteve ligjore për të lehtësuar huamarrjen e komunave është gjithashtu aspekt shumë i rëndësishëm në këtë drejtim. Numri i zyrtarëve të prokurimit publik parashihet të rritet për shpenzim më efektiv të buxhetit. Te buxheti për investime kapitale, është i nevojshëm planifikimi më i mirë i mirëmbajtjes nga komunat.

Ky objektivi specifik lidhet me Objektivin 10.5 të SKZH-së dhe PKZH-së, që ka për qëllim që të krijojë financa publike të qëndrueshme dhe efektive dhe tërthorazi e përbush SDG 16, që mes tjerash synon të krijojë institucione të forta.

Të bëhet:

- *Rishikimi i kushteve dhe kriterëve për të përcaktuar banorët rezidentë në komune për të ndarë më mirë fondet qeveritare*
- *Rishikimi i politikave buxhetore për grantet specifike bazuar në kompetenca*
- *Të avancohet buxheti i përgjegjshëm gjinor*
- *Rritja e fleksibilitetit në shpenzime operative*
- *Rritja e gamës së të hyrave vetanake duke vendosur tarifa/taksa shtesë, si p.sh: për mbrojtjen e mjedisit, për shit-blerjen e patundshmërive apo në rastin e trashëgimisë*
- *Krijimi i mekanizmave për grumbullim më të mirë të llogarive të arkëtueshme*
- *Organizimi i fushatave vetëdijësuese për rritjen e shkalles së inkasimit të të hyrave vetanake*
- *Krijimi kushteve ligjore për të lehtësuar huamarrjen e komunave*

Objektivi specifik 4.2: Avancimi i proceseve dhe resurseve në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale

Konsolidimi i proceseve dhe krijimi i resurseve të mjaftueshme për planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale kontribuon në përmirësimin e qeverisjes ekonomike. Në këtë drejtim, është e nevojshme që komunat të kenë njësi për planifikim dhe zhvillim të politikave, si dhe të ngritën kapacitetet profesionale. Procesi i hartimit të dokumenteve strategjike me rëndësi për ekonominë lokale kërkon që hisedarët të përfshihen që nga fillimi i procesit të hartimit deri në fund, jo vetëm për “validim” të analizës dhe objektivave. Pjesëmarrja e grave dhe të rinjve duhet të inkurajohet. Gjithashtu, është e nevojshme që të krijohet një kornizë standarde për monitorimin e zbatueshmërisë së dokumenteve strategjike, sidomos për ato që lidhen me ekonominë. Për më tepër, strategjitë aktuale që dallojnë konsiderueshëm nga korniza strategjike nacionale, duhet të rishikohen, ashtu që të jenë në përputhje me dokumentet strategjike të nivelit qendror. Për të krijuar mundësi të revidimit, do të krijohet mundësia që të rishikohen Planet Zhvillimore Komunale (për shembull: përmes votimit me shumicë të kualifikuar). Për fund, por jo me më pak rëndësi, do të intensifikohet puna për finalizimin e hartave zonale komunale.

Nuk ka ndonjë objektivi specifik në SKZH-së dhe PKZH-së që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë objektivi; e njëjta vlen edhe për SDG.

Të bëhet:

- *Fuqizimi i kapaciteteve për planifikim dhe zhvillim të politikave*
- *Ngritja e kapaciteteve profesionale brenda komunave për hartimin e dokumenteve strategjike*
- *Krijimi i kornizës standarde për monitorimin e zbatueshmërisë së dokumenteve strategjike dhe ndikimit të tyre*
- *Përfshirja e hisedarëve në hartimin e dokumenteve strategjike që nga fillimi i procesit*
- *Krijimi i mundësisë që të rishikohen Planet Zhvillimore Komunale (p.sh. përmes votimit me shumicë të kualifikuar)*
- *Finalizimi i hartave zonale komunale*
- *Harmonizimi i strategjive komunale me strategjitë nacionale*

Objektivi specifik 4.3: Përmirësimi i shërbimit dhe përgjegjshmërisë komunale

Ngritja e cilësisë së shërbimeve publike dhe administrative, si dhe përmirësimi i llogaridhënies, i kontribuojnë mirëqenies qytetare dhe lehtësojnë veprimtarinë biznese. Për t'u arritur ky objektivi specifik, do të punohet në digjitalizimin e shërbimeve komunale dhe shfaqjes së tyre për aplikim në E-Kosova, duke reflektuar në aftësitë e qytetarëve për t'i shfrytëzuar shërbimet e digjitalizuara. Për më shumë, do të inkurajohet themelimi i ndërmarrjeve komunale të reja për ta përmirësuar punën dhe cilësinë e shërbimeve komunale. Komunave do t'u ofrohet mbështetje për ta bërë vendosjen e tarifave konform kostove të shërbimeve dhe kështu të ndihmohet zvogëlimi i barrës administrative. Në fushën e inspektimeve, është e rëndësishme që të behet qartësimi i kompetencave në mes të nivelit lokal dhe qendror.

Ky objektivi specifik lidhet me Objektivin 10.2 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon rritjen e efektivitetit të shërbimit publik dhe llogaridhënies në administratën publike. Edhe ky objektivi specifik i kontribuon arritjes së SDG 16, që ka të bëjë me institucionet e forta.

Të bëhet:

- *Digjitalizimi i shërbimeve komunale dhe shfaqja e tyre për aplikim në E-Kosova*
- *Ofrimi i mbështetjes për komuna që ta bëjnë vendosjen e tarifave konform kostove të shërbimeve*
- *Qartësimi i kompetencave në fushën e inspektimeve komunale*

Objektivi specifik 4.4: Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal

Dialogu me komunitetin e biznesit, bashkëpunimi me nivelin qendror, si dhe krijimi i aleancave komunale përtej kufijve janë të rëndësishme për adresim më të mirë të sfidave ekonomike dhe krijim të mundësive të përbashkëta për zhvillim. Për ta përmirësuar dialogun publiko-privat, është e nevojshme që të stimulohet krijimi i shoqatave lokale për përfaqësim të sektorit privat dhe të krijohen mekanizma për bashkëpunim sistematik me shoqatat e krijuara. Gjithashtu, duhet të krijohen politikatat stimuluese për anëtarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, ashtu që të angazhohen më shumë në artikulimin e sfidave dhe nevojave për zhvillim të ekonomisë lokale. Për bashkëpunim ndërkomunal, duhet që të identifikohen fushat e përbashkëta me potencial zhvillimor dhe të përkrahët zhvillimi i tyre. Ngjashëm edhe tek rasti i bashkëpunimit komunal ndërkufitar. Tek bashkëpunimi me nivelin qendror, do të krijohet mekanizmi i veçantë për koordinimin e procesit të financimit të investimeve nga niveli qendror në nivelin lokal.

Në terma të gjerë, ky objektivi specifik lidhet me Objektivin 10.3 të SKZH-së dhe PKZH-së, që ka për synim përmirësimin e performancës së komunave, si dhe përmbush SDG 17 (Partneritetet për qëllimet).

Të bëhet:

- *Identifikimi i fushave të përbashkëta me potencial zhvillimor ne kuadër te bashkëpunimit ndërkomunal*
- *Stimulimi i krijimit të shoqatave lokale për përfaqësim të sektorit privat dhe krijimi i mekanizmave për bashkëpunim sistematik me shoqatat e krijuara*
- *Krijimi i politikave stimuluse për anëtarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane*
- *Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar*
- *Krijimi i mekanizmit të veçantë për koordinimin e procesit të financimit të investimeve nga niveli qendror në nivelin lokal*

Treguesit

Tabela 3 dhe Tabela 4 paraqesin treguesit për dy nivelet e objektivave. Këta tregues janë nxjerrë nga SKZH-ja dhe PKZH-ja, si dhe nga burimet tjera që matin performancën e pushtetit lokal. Përderisa vlerat e këtyre treguesve janë paraqitur në nivel vendi, të njëjtat mund të zbërthehen edhe në nivel komunal, përjashtuar disa raste ku zbërthimi (do të) mund të bëhet vetëm sipas regjionit. Synimet mund të përshtaten në strategjitë e komunave për zhvillim ekonomik lokal krahas gjendjes së tyre ekzistuese. Në Shtojcë paraqiten definicionet për secilin tregues dhe ofrohen shënime metodologjike kudo që është e nevojshme.

Tabela 3: Treguesit e ndikimit

Objektivi	Treguesi	Baza në nivel vendi	Burimi	Propozim synimi 2026	Propozim synimi 2030
1. Ekonomi lokale konkurruese	<i>Produktiviteti (VShB/numri i punëtorëve)¹⁶ (EUR)</i>	24,126 EUR (2021)	ASK	+30%	+50%
2. Punësim gjithëpërfshirës	<i>Norma e punësimit (%)</i>	20% (TM2 2021)	ASK	45%	55%
3. Infrastrukturë lokale e përmirësuar	<i>Përqindja e ndërmarrjeve “të kënaqura” me infrastrukturën lokale (%)</i>	n/a	Anketë	Së paku 60% të kënaqur	Së paku 70% të kënaqur
4. Qeverisje ekonomike efektive dhe bashkëpunuese	<i>Indeksi i administratës lokale (1-10)</i>	3.9 (2020)	Indeksi i konkurrueshmërisë së komunave (USAID)	6.0	8.0

¹⁶ Të përfshira vetëm aktivitetet ekonomike (NACE: A-C, F-M, dhe S)

Tabela 4: Treguesit e rezultatit

Obj.	Objektivi specifik	Treguesi	Baza në nivel vendi	Burimi	Propozim synimi 2026	Propozim synimi 2030
Obj. 1	1.1. Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal	<i>Investimet e Huaja Direkte (IHD) për kokë banori (EUR)</i>	236.8 EUR (2021)	BQK	350 EUR	470 EUR
	1.2. Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal	<i>Vlera e Shtuar Bruto (VShB) për njësi pune vjetore (NJPV) në bujqësi (EUR)</i>	1428 EUR (2019)	MBPZHR	1700 EUR	2000 EUR
		<i>Vizitorët ndërkombëtarë për kokë banori</i>	3.2 (2021)	Hyrjet në pikat kufitare (ASK/Policia e Kosovës)	+30%	+50%
	1.3. Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion	<i>Përdorimi i mjeteve të digjitalizimit në procese të përgjithshme të prodhimit/punës (%)</i>	25.02% (2021)	OEK	35%	45%
		<i>Firmat që prezantuan një produkt/shërbim të ri ose një inovacion në procese (%)</i>	36.6% (2019)	Banka Botërore	50%	60%
Obj. 2	2.1. Zvogëlimi i hendekut të shkathtësive në tregun e punës	<i>Cilësia e trajnimit profesional të punëtorëve që ofron tregu lokal (1-5)</i>	3.29	Indeksi i konk. së komunave (USAID)	3.9	4.3
	2.2. Rritja e punësimit të dinjitetshëm për gra, të rinj dhe kategori të cënueshme	<i>Norma e punësimit të grave (%)</i>	16% (TM2 2021)	ASK	30%	40%
		<i>Të rinjtë që nuk janë në punësim, arsim apo trajnim (NEET) (%)</i>	32.5 (TM2 2021)	ASK	20%	15%
Obj. 3	3.1. Përmirësimi	<i>Infrastruktura rrugore (%)</i>	52% (2021)	MAPL	60%	70%

	infrastrukturës së transportit lokal dhe shërbimeve	<i>Parkingjet publike (%)</i>	47% (2021)	MAPL	60%	70%
		<i>Transporti publik (%)</i>	56.6% (2021)	MAPL	65%	75%
	3.2. Sigurimi i qasjes në infrastrukturë përcjellëse	<i>Popullsia me qasje në sistemet publike të ujësjellësit (%)</i>	78% (2020)	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit	92%	95%
		<i>Popullsia me qasje në sistemet publike të kanalizimit (%)</i>	65% (2020)	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit	78%	85%
		<i>Popullsia me qasje në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza (%)</i>	3 (2020)	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit	45%	60%
	3.3. Menaxhimi i integruar i mbeturinave	<i>Mbetjet e ngurta komunale të grumbulluara dhe të menaxhuara në objekte të kontrolluara në totalin e mbetjeve komunale të krijuara (%)</i>	89.3% (2021)	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës	90%	99%
		<i>Mbetjet e ngurta komunale të ricikluara në totalin e mbetjeve komunale të krijuara (%)</i>	2-5% (2020)	GIZ	12%	30%
	3.4. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në infrastrukturë	<i>Kursimet e energjisë në infrastrukturë (%)</i>	n/a	Komunat	-30%	-60%
Obj.4	4.1. Financa lokale të qëndrueshme dhe efektive	<i>Përqindja e realizueshmërisë së buxhetit (mesatarja)</i>	85%	MAPL	90%	100%
		<i>Të hyrat vetanake – niveli komunal</i>	90 mil. EUR	MFPT	Së paku +20%	Së paku +40%
	4.2. Avancimi i proceseve dhe	<i>Niveli profesional i zyrtarëve lokalë</i>	3.36 (2020)	Indeksi i konk. së	3.8	4.2

	resurseve në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale	(1-5)		komunave (USAID)		
		<i>Numri i komunave me njësi për planifikim dhe zhvillim të politikave</i>	0 (2022)	MAPL	19	38
4.3. Përmirësimi i shërbimit dhe përgjegjësisë komunale		<i>Shërbimet Publike Administrative (%)</i>	81.7% (2021)	MAPL	85%	95%
		<i>Treguesi i përgjegjshmërisë komunale (%)</i>	53.9% (2021)	MAPL	70%	80%
		<i>Shërbimet komunale në e-Kosova</i>	17	MAPL	+100%	+150%
4.4. Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal		<i>Numri i projekteve me komunat tjera (brenda dhe jashtë kufirit)</i>	n/a	MAPL	+40%	+80%
		<i>Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria (1-10)</i>	4.94 (2020)	Indeksi i konk. së komunave (USAID)	6	8

8. Zbatimi, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi

Zbatimi i PNZHEL 2030 do të bëhet përmes strategjive të zhvillimit ekonomik lokal dhe planeve të tyre të veprimit të hartuara nga komunat, si dhe përmes planeve institucionale të ministrive. Deri në fund të 2024-ës, komunat që nuk kanë strategji të zhvillimit ekonomik lokal, duhen t'i hartojnë ato, ndërsa komunat të cilat veçse kanë strategji në fuqi me ndryshime të theksuara nga ky program, duhet ta bëjnë rishikimin e tyre.¹⁷ Si mekanizëm për të nxitur komunat që të zhvillojnë strategjitë e tyre për zhvillim ekonomik lokal në harmoni me këtë program, do të shfrytëzohet sistemi i matjes së performancës dhe grantit të performancës .

MAPL-ja do të krijojë Komitetin Zbatues për PNZHEL 2030 për ta siguruar një koordinim të shëndoshë dhe efektiv midis institucioneve gjatë zbatimit. Ky Komitet do të përbëhet nga institucionet që kanë marrë pjesë në grupin punues të programit. Komunat do të përfaqësohen përmes Kolegjiumit për Zhvillim Ekonomik Lokal.

Të dhënat e monitorimit do të mblidhen në baza vjetore. Bazuar në këto të dhëna, do të hartohen raporte të rregullta të progresit për të pasqyruar nivelin e zbatueshmërisë së këtij dokumenti. MAPL-ja do të jetë

¹⁷ Komunat detyrohen që strategjitë e tyre për zhvillim ekonomik lokal t'i zhvillojnë në frymën e barazisë gjinore, në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, ashtu sic është zhvilluar PNZHEL.

institucioni përgjegjës për koordinimin e procesit të grumbullimit të të dhënave dhe për hartimin e raportit vjetor të progresit të PNZHEL 2030. Raporti vjetor i progresit do të publikohet në ueb faqen zyrtare të MAPL-së.

Matja e zbatueshmërisë së PNZHEL 2030 do të bëhet përmes treguesve, të cilët ndahen në tri nivele: tregues të ndikimit, për objektivat strategjike; tregues të rezultatit, për objektivat specifike; dhe tregues të produktit, për aktivitetet strategjike. Përderisa dy nivelet e para të treguesve janë paraqitur në seksionin më lartë, treguesit e produktit do të përcaktohen në strategjitë lokale të zhvillimit ekonomik dhe planet e veprimit të nivelit qendror. Vlerësimi i ndikimit do të organizohet siç vijon:

- Vlerësimi i ndërmjetëm në vitin 2026;
- Vlerësimi i dytë në vitin 2029, për ta informuar procesin e përgatitjes së PNZHEL të ardhshëm; dhe
- Vlerësimi ex-post.

Varësisht nga dinamikat në kontekstin social dhe ekonomik, mund të jetë e nevojshme që të ketë ndryshim të kohës së vlerësimit të parë dhe të dytë. Vlerësimet mund t'i nënshtrohen tërë PNZHEL apo vetëm një pjese të këtij dokumenti.

Për ta mundësuar realizimin e suksesshëm të monitorimit, mbledhja e të dhënave dhe publikimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë sistematike. Duke qenë se treguesit pritet të zërthehen në nivel të komunave (ose të paktën në nivel të regjioneve), është tejet e rëndësishme që mbledhja e të dhënave të jetë asisoj që të krijojë mundësinë e zërthimit të mëtutjeshëm, pa cenuar saktësinë e tyre.

Institucionet përgjegjëse për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave do të jenë pjesë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të PNZHEL 2030. Për tre tregues, përkatësisht për infrastrukturën në përgjithësi, eficientë e energjisë në infrastrukturë dhe për financat e qëndrueshme duhet të zhvillohen instrumente për mbledhje të të dhënave në ndërkohë, meqenëse aktualisht mungojnë. Gjithashtu, Indeksi i Konkurrueshmërisë së Komunave, i cili është burim i shumë treguesve për PNZHEL 2030, duhet të vazhdojë të prodhohet në baza vjetore. Herën e fundit kur ky indeks është prodhuar ka qenë viti 2021.

9. Projektionet financiare për zbatim të PNZHEL

Projektionet për zbatimin e PNZHEL janë përgatitur duke aplikuar një qasje shumë-dimensionale: a) duke përdorur projektionet e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për 2024-2026, b) kufijtë e shpenzimeve për organizata buxhetore (komunat) bazuar në dokumentet e fundit planifikuese fiskale c) supozimet për projeksione afatgjata dhe d) ndarjet buxhetore sipas sektorëve.

- Hapësira fiskale shtesë e identifikuar është paraqitur si hapësirë fiskale në dispozicion për të zbatuar objektivat dhe prioritetet e PNZHEL-së.

Hapësira fiskale e identifikuar në këtë dokument, bazohet në një skenar që supozon se:

1. Qeveria mund t'i ndajë deri në rreth 21%¹⁸ të fondeve, që gjenerohen si rezultat i nënshpenzimeve në kategorinë e shpenzimeve kapitale dhe hapësira fiskale e paraparë nga deficitet buxhetor për qëllime të zbatimit të këtij program.
2. Projektionet e të hyrave, janë vlerësuar duke përdorur një peshë mesatare historike si pjesëmarrje në BPV. Po ashtu, parashikimi i të hyrave vetakane të komunave, parasheh një rritje vjetore mesatare prej rreth 5.4%.
3. Disbursimet nga fondet e donatoreve, përpos Grantit të performancës së Komunave, që vlersohet mesatarisht të jetë rreth 7 milionë Euro në vit, parashihen edhe grante tjera të cilat mund të vijnë nga donatorë dhe organizata tjera të cilat do të mund të ndërlidhen me prioritetet dhe objektivat e PNZHEL. Këto projekte nga donatorët/organizatat si GIZ, KfW, USAID, apo Zyra e BE-së të cilat ndërlidhen me punësim, digjitalizim, treg të punës, supozohet të kenë një kontribut prej rreth 3 milionë Euro në vit, dhe si të tilla përfshihen në hapësirën fiskale të gjeneruar.
4. Duhet theksuar se parashikimet afatgjata për 2027-2030 janë të përgatitura mbi pasiguri që lidhen me zhvillimet ekonomike, zhvillimet politike dhe masat e tjera të mundshme fiskale në të ardhmen.

Mbi këto supozime, për llogaritjen e hapësirës fiskale janë marrë parasysh 21% të hapësirës të përgjithme fiskale, 21% të hapësirës nga nën shpenzimi i projekteve kapitale, grantet e performancës komunale, grantet dhe fondet tjera nga donatorët dhe rreth 5.4% e të hyrave vetanake komunale e cila përkon me rritjen mesatare të paraparë të këtyre të hyrave.

¹⁸ Kjo përqindje është përcaktuar duke pasë parasysh pjesëmarrjen e buxhetit lokal në buxhetin e përgjithshëm, bazuar në buxhetin për vitin 2023. Buxheti i tërësishëm për nivel komunal: EUR 660 mil nga EUR 3.2 miliard të buxhetit të përgjithshëm.

Tabela 5: Hapësira fiskale për zbatim të PNZHEL

Skenari Bazë	Projeksionet e KASH				Projeksionet Afatgjata				
	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
<i>Në milionë Eur</i>									
Të hyrat buxhetore totale	2,494	2,884	2,991	3,181	3,397	3,436	3,626	3,819	4,028
Shpenzimet Buxhetore	2,541	3,224	3,280	3,413	3,499	3,637	3,829	4,022	4,231
Deficiti sipas rregullës fiskale	13	(204)	(212)	(171)	(85)	(201)	(202)	(203)	(203)
Deficiti sipas rregullës fiskale % e BPV	0.1%	2.0%	-2.0%	-1.5%	-0.7%	-1.6%	-1.5%	-1.5%	-1.4%
Hapësira Fiskale nga deficit			2	59.27	164	47	60	73	88
Nën ekzekutimi i shpenzimeve kapitale			160	161	165	161	169	178	187
Të hyrat vetanake-lokale	87.4	98.5	105.5	109.7	115.4	121.7	128.3	135.2	142.6
Granti i Performancës	8	8	7	7	7	7			
Grantet tjera			3	3	3	3	3	3	3
Hapësira Fiskale % e BPV			1.5%	1.9%	2.6%	1.7%	1.7%	1.8%	1.9%
Hapësira Fiskale			49.74	62.38	85.26	60.30	58.03	63.03	68.49

Ndarja e hapësirës fiskale shtesë të identifikuar në seksionin e mësipërm, do të bëhet në përputhje me objektivat e programit për sektor, si dhe prioritetet e identifikuar. Në përputhje me prioritetet dhe objektivat e identifikuar brenda PNZHEL, parashihet ndikim kryesisht në sektorin e Cështjeve Ekonomike dhe Qeverisjes së Përgjithshme.

Tabela 6: Financimi i PNZHEL sipas sektorëve kryesorë


	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Hapësira Fiskale	49.7	62.4	85.3	60.3	58.0	63.0	68.5
Qeverisja e Përgjithshme	11.2	14.4	20.2	13.9	13.4	14.6	15.8
Cështjet Ekonomike	12.7	7.9	10.7	7.6	7.4	8.0	8.7
Të tjera	25.8	40.0	54.3	38.7	37.2	40.5	44.0

Shtojcat

Gjetjet kryesore të anketës me komuna

Ky seksion përmbledh të dhënat e anketës së zhvilluar me drejtorin të zhvillimit ekonomik në komunat e Kosovës. Pyetësorin e kanë plotësuar 31 komuna nga 38 sa janë gjithsej. Nga ata/ato që e kanë plotësuar pyetësorin, 77.4% ishin drejtorë në drejtorinë përkatëse të zhvillimit ekonomik, 12.9% udhëheqës sektori apo departamenti dhe të tjerët (9.7%) ishin zyrtarë.

Figura 1: Pozita e të anketuarve në drejtorinë përkatëse të zhvillimit ekonomik



Sipas të anketuarve, 48.8% e komunave kanë strategji për zhvillimin ekonomik lokal dhe 86.7% e atyre strategjive monitorohen në baza të rregullta. Në përgjigjen e dhënë për strategji, nuk është e qartë nëse të anketuarit i kanë konsideruar edhe planet zhvillimore komunale (PZHK-të) si strategji të zhvillimit ekonomik lokal, duke e pasur parasysh faktin se të njëjtat e trajtojnë edhe temën e ekonomisë. Aktualisht, 12 komuna kanë PZHK në fuqi. Gjithashtu, ndonëse përqindja e monitorimit është e mjaftë e lartë, në

Figura 3: Komunat me strategji të ZhEL





Figura 2: Monitorimi i zbatimit të strategjive ZhEL



shumicën e uebstajteve nuk janë gjetur raporte të monitorimit për zbatueshmerinë e strategjive të deklaruar.

Një pyetje tjetër që u është parashtruar përfaqësuesve të komunave ka qenë se a i kanë të definuar sektorët/fushat me potencial të lartë të zhvillimit ekonomik. Sipas përgjigjeve të pranuar, 80.6% e komunave i kanë të definuar sektorët apo fushat me potencial të lartë ekonomik, për dallim prej 16.1% që nuk i kanë të definuar këta sektorë. Një përqindje e neglizhuese (3.2%) e të anketuarve nuk kishin informata në lidhje me këtë pyetje. Bujqësia me 67.7%, turizmi me 58.1% dhe industria përpunuese/prodhuese me 29% janë sektorët që dominojnë në përcaktimet e komunave rreth sektorëve me prioritet ekonomik.

Figura 5: Komunitat me sektorë ekonomik të definuar






Figure 4: Sektorët me potencial të lartë ekonomik



51.6% përfaqësuesve komunal të anketuar deklaruan se komunat e tyre kanë projekte me komuna tjera që lidhen me zhvillimin ekonomik. Projektet e përbashkëta janë kryesisht të natyrës infrastrukturore, si për shembull: asfaltim i rrugëve, hapje dhe definim i shtigjeve për qëllime turistike, rregullim i shtratit të lumit.


Figura 6: Komunitat me projekte ndër-komunale



Në pyetjen se a ka pasur komuna përkatëse investime me efekt të konsiderueshëm në zhvillim dhe krijim të vendeve të punës në tri vitet e fundit, 61.3% janë të anketuarve janë përgjigjur me po, ndërsa 32.2%


me jo; pjesa e mbetur (6.5%) nuk kishin informacion për këtë. Ndonëse në pyetjen e parashtruar nuk ishte e përcaktuar se a është fjala për investime publike apo private, shumica e të anketuarve si duket kanë menduar që është fjala vetëm për investime publike. Kjo, megjë shumica e investimeve që përmenden janë investime infrastrukturore (p.sh. Infrastruktura të zona ekonomike/industriale).

Figure 7: Përqindja e komunave që kanë pasur investime me efekt të konsiderueshëm në ekonomi në tri vitet e fundit



Të dhënat tregojnë se 67.7% e të anketuarve konsiderojnë se kapacitetet e komunës për hartimin e projekteve për tërheqje të fondeve nga donatorët janë të kënaqshme, 19.4% të kënaqshme dhe 12.9% të dobëta. Kjo e dhënë duhet të interpretohet me kujdes, duke qenë se përfaqësuesit e komunave mund të kenë qenë subjektivë për vlerësimin e kapaciteteve të tyre.

Figure 8: Vlerësimi për kapacitetet e komunave për të hartuar projekte për tërheqje të fondeve nga donatorët



Sipas përfaqësuesve komunal të anketuar, 90.2% e komunave e kanë bërë inventarizimin e pronës komunale, ndërsa 6.5% nuk e kanë bërë këtë. Përqindja e mbetur është e papërcaktuar, sepse i anketuari/e anketuara nuk ishte në dijeni. Në 75% të rasteve, bazuar në të anketuarit, lista e pronave komunale është e qasshme për publikun, ndërsa në 10.7% nuk është e qasshme. Pjesa e mbetur është e papërcaktuar, sepse i anketuari/e anketuara nuk e dinte. Përgjigjet rreth kësaj teme janë dukshëm më pozitive krahasuar me indikatorin e dhënë në raportin e performancës së komunave, ku tregohet se vetëm 44.2% komunave e kanë përgatitur dhe publikuar listën e pronave publike të planifikuara për dhënie në shfrytëzim.

Figura 10: Komunat me regjistër të pronës komunale






Figura 9: Komunat me regjistër të pronës komunale të publikuar



Të anketuarit nga komuna janë ftuar që t'i tregojnë pengesat kryesore që pengojnë zhvillimin ekonomik lokal. Vështirësitë në gjetjen e punëtoreve (39%), niveli i ulët i investimeve (32%) dhe buxheti i pamjaftueshëm komunal (32%) janë pengesat më të përmendura nga të anketuarit dhe kështu i prijnë listës. Të tjera pengesa që kanë frekuencë relativisht të lartë janë ndihma e pamjaftueshme nga niveli qendror (26%), përkrahja e kufizuar e bujqësisë, industrisë dhe NVM-ve (19%) dhe problemet që lidhen me shfrytëzimin e pronës (16%). Për më shumë, shihni Figurën 11.


Figura 11: Pengesat kryesore të identifikuar për zhvillim ekonomik lokal



Tutje, një listë e barrierave potenciale të identifikuar paraprakisht është ndare me të anketuarit dhe të njëjtit janë ftuar që ta bëjnë një vlerësim për secilën prej tyre nga 1 deri në 5, ku 1 nënkupton që nuk është fare barrierë, ndërsa 5 barrierë shumë e madhe. Sipas mesatareve të gjeneruara, paqartësia në mes të kompetencave të nivelit qendror dhe atij lokal dhe qasja e kufizuar në financa me nga 3.06 secila,


mungesa e përkrahjes për sektorët me potencial të rritjes me 3.03, qëndrueshmëria financiare e komunave me 2.94 dolën të jenë barrierat më serioze. Barrierat tjera janë të paraqitura në Figurën 12.

Figura 12: Vlerësimi dhe rangimi i barrierave potenciale




Përgjigjet e dhëna nga të anketuarit në lidhje me atë se çka duhet të bëjnë komunat për ta përshpejtuar zhvillimin ekonomik lokal deri në 2030-ën, janë grupuar në mënyrë që të identifikohen propozimet më të rëndësishme. Sipas përpunimit të bërë, krijimi dhe funksionalizimi i zonave ekonomike (39%), rregullimi i infrastrukturës së përgjithshme (29%), mbështetja teknike dhe financiare e NVM-ve (29%), dhe ngritja e shkathtësive tek fuqia punëtore (26%) janë propozimet kryesore nga të anketuarit. Propozimet tjera janë të renditura në Figurën 13.

Figura 13: Propozimet për nivelin komunal për ta përshpejtuar zhvillimin ekonomik nëpër komuna deri në 2030-ën




Në lidhje me atë se çka duket të bëjë niveli qendror për ta përsheptuar zhvillimin ekonomik lokal deri në 2030-ën, gjithashtu janë nxjerrë propozimet kryesore dhe janë paraqitur në Figurën 14. Rritja e buxhetit komunal (26%) dhe ofrimi i kushteve të favorshme për tërheqje të investitorëve (23%) janë dy propozimet më të shpeshta.

Figure 14: Propozimet për nivelin qendror për ta përsheptuar zhvillimin ekonomik nëpër komuna deri në 2030-ën



Të dhënat e anketës tregojnë se fushat me më së shumti interes të përbashkët ekonomik për komunat janë turizmi (61.3%) dhe bujqësia (58.1%); pas këtyre dy fushave vjen industria me një përqindje pak më të ulët (25.8%). Fushat tjera janë të paraqitura në Figurën 15.

Figura 15: Fushat me interes të përbashkët ekonomik për komunat



Duke qenë se strategjia synon të jetë gjithëpërfshirëse, synimi ishte që përmes anketës gjithashtu të kuptoheshin grupet e cenueshme ekonomikisht nëpër komuna. Kategoritë kryesore sipas të anketuarve përfshijnë: gratë të cilat jetojnë në zona rurale, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, pensionistët, bizneset artizanale, shitësit me pakicë dhe të ngjashmet.

Për shumicën dërrmuese të anketuarve (83.9%) migrimi i popullatës është “problem shumë i madh” ose “problem i madh”. Ky problem duket të jetë më i theksuar në komuna më të vogla. Në anën tjetër, sipas të anketuarve, 41.9% e komunave kanë shoqata të biznesit apo organizata të ngjashme që i përfaqësojnë interesat e sektorit privat.

Figure 17: Vlerësimi i migrimit si problem për nivelin komunal





Figure 16: Komunitet me asociacione (oda) të biznesit apo të organizatave të ngjashme (%)



Gjetjet kryesore të anketës me biznese

Ky seksion bën përmbledhjen e gjetjeve kryesore nga anketa e zhvilluar me biznese. Pyetësi i përpiluar për nevoja të kësaj ankete është shpërndarë tek 5,000 biznese të përzgjedhura nga baza e të dhënave të ARBK-së, sipas metodës së rastësisë. Për ta rritur madhësinë e mostrës, gjithashtu është bashkëpunuar me Oden Ekonomike të Kosovës (OEK), ashtu që pyetësi të ndahet me anëtarët e saj. Në fund, nga të gjitha bizneset e kontaktuar, janë pranuar 57 pyetësorë të kompletuar dhe në bazë të tyre janë nxjerrë rezultatet. Përkundër mostrës relativisht të vogël, megjithatë janë pranuar përgjigje të vlefshme që do të merren në konsideratë gjatë përpilimit të Programit. Sidoqoftë, për shkak të madhësisë së mostrës, rezultatet, sidomos ato të natyrës sasiore, duhet të interpretohen me kujdes. Prej atyre që e kanë plotësuar pyetësin, shumica dërrmuese (98%) ishin pronarë apo menaxherë, ose mbanin të dy pozitat.

Për më tepër, shumica e të anketuarve (49.1%), ashtu siç është demografia e përgjithshme në Kosovë, ishin nga Prishtina. Nga rajonet tjera dominonte lehtë Ferizaji (17.5%) (për më shumë, shih Figurën 18). Sa i përket veprimtarisë, dominon tregtia me shumicë dhe pakicë me 17.5%, industria përpunuese me 14%, ndërtimtaria dhe financat me 12.3% secila dhe TIK me 10.5%. Pjesa e mbetur janë shërbime dhe veprimtari tjera (shih Figurën 19).

Figura 21: Regjioni





Figura 18: Veprimtaria



Rreth e 63% e bizneseve të anketuara deklaruan se kanë 1 deri në 5 punëtorë, 14% kanë 6 deri në 10 punëtorë, 10.5% kanë 11 deri në 50 punëtorë, ndërsa pjesa e mbetur deklaruan se kanë më shumë se 50 punëtorë. Në pyetjen rreth qarkullimit në krahasim me vitin e kaluar, 38.6% e firmave raportuan se kanë performuar shumë më mirë ose më mirë, 45% deklaruan se kanë performuar më keq ose shumë më keq; pjesa e mbetur (15.8) raportuan se performanca ka qenë e njëjtë.

Figure 19: Numri i punëtorëve






Figure 20: Qarkullimi në krahasim me vitin e kaluar




Ngjashëm si te rasti i komunave, bizneset e anketuara janë ftuar që t'i tregojnë pengesat kryesore që pengojnë zhvillimin ekonomik lokal. Inflacioni/rritja e kostove me 55%, vështirësitë në gjetjen e punëtorëve (mungesa e kualifikimit dhe migrimi) me 39% dhe konkurrenca e padrejtë me 32% janë pengesat më të përmendura nga të anketuarit. Për t'i parë pengesat tjera të identifikuara dhe përqindjen e tyre, shih Figurën 22.

Figura 22: Pengesat kryesore të identifikuara nga bizneset




Sikurse te anketa me komuna, një listë e barrierave potenciale të identifikuara paraprakisht, është ndarë edhe me bizneset dhe të njëjtat janë ftuar që ta bëjnë një vlerësim për secilën prej tyre nga 1 deri në 5, ku 1-shi nënkupton që nuk është fare barrierë, ndërsa 5-shi barrierë shumë e madhe. Sipas rezultateve të prodhuara, konkurrenca e pandershme me mesatare 3.60, pasiguria në investime me 3.51 dhe mbështetja financiare nga komuna për biznesin dhe qëndrueshmëria financiare e biznesit me 3.12 secila dolën të jenë barrierat më serioze. Barrierat tjera janë të paraqitura në Figurën 12.

Figure 23: : Vlerësimi dhe rangimi i barrierave potenciale




Propozimet e dhëna nga bizneset në lidhje me atë se çka duhet të bëjnë komunat për ta përshpejtuar zhvillimin ekonomik lokal deri në 2030-ën, janë grupuar në mënyrë që të identifikohen propozimet më të rëndësishme. Mbështetja e bizneseve përmes granteve dhe subvencioneve (21%), rregullimi i infrastrukturës së përgjithshme (12%), ndihma për ngritjen e shkathtësive të fuqisë punëtore (12%) dhe zvogëlimi i ngarkesave tatimore lokale (12%) rezultuan të jenë propozimet kryesore nga bizneset e anketuara. Propozimet tjera janë të renditura në Figurën 24.

Figure 24: Propozimet për nivelin komunal për ta përshpejtuar zhvillimin ekonomik nëpër komuna deri në 2030-ën



Propozimet për nivelin qendror për ta përshpejtuar zhvillimin ekonomik lokal deri në 2030-ën, gjithashtu janë grupuar dhe renditur në Figurën 14. Fondet për mbështetjen e sektorit privat (26%), luftimi i korrupsionit dhe informalitetit (11%), si dhe krijimi i mundësive për ngritje të shkathtësive tek të rinjtë (7%) janë tri propozimet më të shpeshta nga bizneset e anketuara.


Figure 25: Propozimet për nivelin qendror për ta përshpejtuar zhvillimin ekonomik nëpër komuna deri në 2030-ën



Në pyetjen rreth grupeve më të cenueshme ekonomikisht në komunën përkatëse, më të përmendurat ishin: bizneset e vogla dhe të reja, veprimtaritë artizanale, të rinjtë dhe komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë.

Nga anketa del se 56.1% e bizneseve hasin në vështirësi në gjetjen e punëtorëve (Figura 26). Disa nga profilet të cilat mungojnë më së shumti, sipas tyre, janë: salduesit, inxhinierët softuerik me përvojë, operatorët e pajisjeve, axhustatorët, etj.

Figura 26: Vështirësitë në gjetjen e punëtorëve



Për pjesën më të madhe të bizneseve të anketuara (86.0%), migrimi i popullatës është “problem shumë i madh” ose “problem i madh”. Një përqindje shumë e vogël (15.8%) e bizneseve thonë se kanë shoqata lokale, të cilat i përfaqësojnë interesat e tyre ekonomike. Pjesa dërrmuese kanë deklaruar se komuna e tyre nuk ka shoqatë të tillë ose nuk janë në dijeni për këtë. Edhe ato pak biznese që thonë se komuna e tyre ka shoqata të tilla, kur janë ftuar që t’i identifikojnë ato, u janë referuar atyre të nivelit qendror. Nga kjo e dhënë mund të arrihet në përfundim se shumë pak komuna kanë shoqata të biznesit të nivelit lokal dhe se ato të cilat kanë, nuk janë shumë aktive që bizneset të jenë të informuara për aktivitetin e tyre.

Figure 27: Vlerësimi i migrimit si problem për nivelin





Figure 28: Shoqatat e biznesit në nivelin komunal



Përmbledhja e sfidave fillestare nga grupi punues

Sfidat	Pengesat kryesore
<p>Resurset e pamjaftueshme financiare</p> <p>Inkasimi jo i kënaqshëm i të hyrave vetanake komunale</p> <p>Varësia e madhe buxhetore e nivelit lokal nga grantet qeveritare</p> <p>Kuadri ligjor që kufizon në masë të madhe huamarrjen komunale</p> <p>Pengesat e natyrës rregullative për shpenzimin e buxhetit</p> <p>Mosarritja e vetëqëndrueshmisë financiare nga komunat</p> <p>Detyrimet financiare të pa përmbushura</p> <p>Planifikimi jo i duhur i projekteve investuese</p> <p>Zotimi i pamjaftueshëm i mjeteve financiare në buxhet për projektet investuese shumëvjeçare</p> <p>Dinamika e ngadaltë e realizimit të punimeve</p> <p>Monitorimi jo i vazhdueshëm i realizueshmërisë së projekteve investuese</p> <p>Mungesa e mjeteve të dedikuara për mirëmbajtje të investimeve</p> <p>Mungesa e interesimit të donatorëve për investime</p> <p>Kapacitetet e kufizuara teknike dhe profesionale të kompanive private për kryerjen e punëve publike</p>	<p>(1) Mungesa e qëndrueshmërisë financiare dhe menaxhimi jo efikas i financave</p>
<p>Mosfunksionalizimi i zonave ekonomike</p> <p>Prezenca e madhe e konkurrencës së padrejtë</p> <p>Klima pafavorshme në nivel lokal për joshjen e investimeve</p> <p>Qasja e kufizuar në financa dhe normat e larta</p> <p>Mungesa e një baze të të dhënave për investitorë për investime në komuna</p> <p>Mungesa e materialeve promovuese mbi potencialet investuese komunale</p> <p>Menaxhimi jo i duhur i pronës komunale</p> <p>Mungesa e pronës komunale për ta shfrytëzuar për qëllime investuese</p> <p>Investimet e kufizuara në infrastrukturën publike lokale</p> <p>Mungesa e përkrahjes për sektorët me potencial të rritjes</p> <p>Mbështetja e pamjaftueshme e sektorit të bujqësisë nga ana e institucioneve lokale</p> <p>Përkrahja e kufizuar për zhvillim të turizmit rural (agroturizimit)</p> <p>Anashkalimi trashëgimisë kulturore për promovim të ekonomisë kreative</p>	<p>(2) Niveli i ulët i investimeve dhe zhvillimi i kufizuar i bujqësisë, turizmit dhe industrisë</p>

<p>Kërkesa e kufizuar/tregu i vogël Pasiguria për të investuar Rritja e çmimit për lëndën e parë</p>	
<p>Mungesa e prioritizimit të zhvillimit ekonomik lokal Kapacitetet e kufizuara profesionale për zhvillim ekonomik në institucione komunale Mungesa e dokumenteve strategjike zhvillimore të zbatueshme Mungesa e kapaciteteve për thithje të fondeve nga donatorët Bashkëpunimi i kufizuar dhe jo sistematik me komunitetin e biznesit në nivel komunal Mungesa e koordinimit të nivelit lokal dhe qendror për hartimin e politikave në fushën zhvillimit ekonomik lokal; Paqartësia në mes të kompetencave të nivelit qendror dhe atij lokal Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet komunave për interes të përbashkët, përjashto në projekte infrastrukturore</p>	<p>(3) Kuadri institucional i mangët dhe me bashkëpunim të pamjaftueshëm</p>
<p>Mungesa e shkathtësive në tregun e punës për përmbushje të nevojave të sektorit privat Irkja e fuqisë punëtore, sidomos nga komunat më të vogla Bashkëpunimi i kufizuar në mes të shkollave profesionale dhe sektorit privat Pjesëmarrja e kufizuar e grave në tregun e punës Qendrat e aftësimit profesional me programe që nuk lidhen shumë me nevojat e tregut Hendeku në mes të digjitalizimit të shkollave në zonat urbane dhe ato rurale Mungesa e politikave lokale për fuqizim të kapitalit njerëzor në harmoni me nevojat e tregut të punës</p>	<p>(4) Burimet (kapacitetet) njerëzore jo adekuate dhe niveli i lartë i papunësisë dhe varfërisë</p>
<p>Mungesa e infrastrukturës dhe vetëdijesimit për riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave Shfrytëzimi jo efikas i ujit dhe energjisë Mungesa e planifikimit të përgjegjshëm urban Shkarkimi i kimikateve dhe të materialeve të tjera të rrezikshme nga bizneset në lumenj</p>	<p>(5) Zhvillimi ekonomik lokal shpërfillës ndaj mjedisit</p>

Pasaporta e treguesve

Objektivi	Treguesi	Burimi	Përshkrimi	Shënime metodologjike (nëse është e nevojshme)	Baza në nivel vendi	Propozim synimi 2026	Propozim synimi 2030
5. Ekonomi lokale konkurruese	<i>Produktiviteti (VShB/numri i punëtorëve)¹⁹ (EUR)</i>	ASK	Ky tregues mat nivelin e produktivitetit në ekonomi dhe konsiderohet si “proxy” për konkurrueshmërinë.	Produktiviteti është kalkuluar duke e pjesëtuar Vlerën e Shtuar Bruto (VShB) me numrin e të punësuarve për NACE veprimtaritë ekonomike në vijim: A-C, F-M dhe S. Të dhënat për VShB janë nga llogaritë kombëtare, ndërsa për punësimin nga anketa e fuqisë punëtore.	24,126 EUR (2021)	+30%	+50%
6. Punësim gjithëpërfshirës	<i>Norma e punësimit (%)</i>	ASK	Ky tregues paraqet shkallën zyrtare të të punësuarve në moshë pune (15-64).	Të dhënat zyrtare për punësimin prodhohen duke u bazuar në anketën e fuqisë punëtore. Aktualisht, prodhohen vetëm në nivel vendi, në të ardhmen pritet të prodhohen edhe në nivel të regjioneve.	20% (TM2 2021)	45%	55%
7. Infrastrukturë lokale e përmirësuar	<i>Përqindja e ndërmarrjeve “të kënaqura” me infrastrukturën lokale (%)</i>	Anketë	Ky tregues mat nivelin e kënaqshmërisë së ndërmarrjeve me infrastrukturën lokale (rrugët, transportin në përgjithësi, qasjen në ujë dhe kanalizim, etj.)	Ky tregues duhet të prodhohet duke u bazuar në të dhëna nga një anketë me ndërmarrje. Pyetja që u parashtrohet ndërmarrjeve duhet të ketë opsionin e zgjedhjes nga 1 (aspak e kënaqur) deri në 10 (shumë e kënaqur).	n/a	Së paku 60% të kënaqur	Së paku 70% të kënaqur
8. Qeverisje ekonomike efektive dhe bashkëpunuese	<i>Indeksi i administratës lokale (1-10)</i>	Indeksi i konkurrueshmërisë së komunave (USAID)	Ky tregues mat aftësinë e administratës së qeverisjes lokale në	Ky tregues është nxjerrë nga Indeksi i Konkurrueshmërisë së Komunave (IKK). Metodologjia e IKK-së bazohet në qasjen e	3.9 (2020)	6.0	8.0

¹⁹ Të përfshira vetëm aktivitetet ekonomike (NACE: A-C, F-M, dhe S)

			krijimin e një mjedisi të mirë afarist.	standardizuar të Indeksit të Qeverisjes Ekonomike nga Fondacioni Aziatik. Të dhënat mblidhen përmes anketës me 3,337 firma në 38 komuna të Kosovës. Indeksi vlerëson nivelin profesional të zyrtarëve, integritetin e tyre dhe aspekte tjera të ngjashme.			
--	--	--	---	---	--	--	--

Obj.	Objektivi specifik	Treguesi	Burimi	Përshkrimi	Shënime metodologjike (nëse është e nevojshme)	Baza në nivel vendi	Propozim synimi 2026	Propozim synimi 2030
Obj. 1	1.1. Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal	<i>Investimet e Huaja Direkte (IHD) për kokë banori (EUR)</i>	BQK	Ky tregues paraqet investimet e huaja direkte neto për kokë banori.	Treguesi përbën fluksin e investimeve të reja nga investitorët e huaj minus deinvestimet, të paraqitura në bilancin e pagesave.	236.8 EUR (2021)	350 EUR	470 EUR
	1.2. Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal	<i>Vlera e Shtuar Bruto (VShB) për njësi pune vjetore (NJVP) në bujqësi (EUR)</i>	MBPZHR	Ky tregues mat nivelin e produktivitetit në bujqësi.	Produktiviteti i punës në bujqësi shprehet si totali i Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) në bujqësi me çmime bazë për Njësi Vjetore Pune (NJVP). VSHB-ja përcaktohet si vlera e prodhimit minus vlerën e konsumit të ndërmjetëm. Njësitë vjetore të punës (NJVP) është punësimi ekuivalent me kohë të plotë.	1428 EUR (2019)	1700 EUR	2000 EUR
		<i>Vizitorët ndërkombëtarë për kokë banori</i>	Hyrjet në pikat kufitare (ASK/Policia e Kosovës)	Ky tregues paraqet numrin e hyrjeve të vizitorëve të huaj në pikat kufitare të Kosovës për kokë banori.	Të dhënat ofrohen nga policia kufitare. Është e nevojshme që gjatë hyrjeve të përcaktohet edhe komuna ku do të realizohet vizita.	3.2 (2021)	+30%	+50%

	1.3. Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion	<i>Përdorimi i mjeteve të digjitalizimit në procese të përgjithshme të prodhimit/punës (%)</i>	OEK	Ky tregues mat përqindjen e ndërmarrjeve që përdorin mjete të digjitalizimit në procese të përgjithshme të punës/prodhimit.	Ky tregues është nxjerrë nga një anketë që është realizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës me biznese që përfshijnë sektorët në vijim: turizmin, shitjen me pakicë, prodhimin dhe agrobiznesin. Në raportin e kësaj ankete, përqindja e përdorimit të mjeteve të digjitalizimit është prezantuar në nivel të sektorëve. Vlera e përfshirë këtu përbën mesataren e thjeshtë të katër sektorëve të përmendur më lartë.	25.02% (2021)	35%	45%
		<i>Firmat që prezantuan një produkt/shërbim të ri ose një inovacion në procese (%)</i>	Banka Botërore	Ky tregues paraqet përqindjen e firmave që kanë prezantuar një produkt/shërbim të ri apo një inovacion në procese.	Treguesi është nxjerrë nga Anketa e Ndërmarrjeve, e cila është një anketë në nivel firme. Produktet/shërbimet e reja dhe inovacioni në procese janë dy variabla të ndara. Treguesi këtu paraqet mesataren e këtyre dy variablave.	36.6% (2019)	50%	60%
Obj. 2	2.1. Zvogëlimi i hendekut të shkathtësive në tregun e punës	<i>Cilësia e trajnimit profesional të punëtorëve që ofron tregu lokal (1-5)</i>	Indeksi i konk. së komunave (USAID)	Ky tregues paraqet pikëpamjet e ndërmarrjeve mbi nivelin profesional të punëtorëve që ofron tregu lokal.	Ky tregues është nxjerrë nga Indeksi i Konkurrueshmërisë së Komunave (IKK). Metodologjia e IKK-së bazohet në qasjen e standardizuar të Indeksit të Qeverisjes Ekonomike nga Fondacioni Aziatik. Të dhënat mbledhen përmes anketës me 3,337 firma në 38 komuna të Kosovës. Pyetja: si e vlerësoni cilësinë e trajnimit profesional të punëtorëve që ofron tregu lokal? (1- shumë i ulët, 5 - i	3.29	3.9	4.3

					shkëlqyer). Vlera bazë përbën mesataren e përgjigjeve.			
	2.2. Rritja e punësimit të dinjitetshëm për gra, të rinj dhe kategori të cenushme	<i>Norma e punësimit të grave (%)</i>	ASK	Ky tregues paraqet shkallën zyrtare të grave punësuar në moshë pune (15-64).	Të dhënat zyrtare për punësimin prodhohen duke u bazuar në anketën e fuqisë punëtore. Aktualisht prodhohen vetëm në nivel vendi, në të ardhmen pritet të prodhohen edhe në nivel të regjioneve.	16% (TM2 2021)	30%	40%
		<i>Të rinjtë që nuk janë të përfshirë në punësim, arsim apo trajnim (NEET) (%)</i>	ASK	Ky tregues paraqet të rinjtë që nuk janë të përfshirë në punësim, arsim apo trajnim (NEET), si përqindje e numrit të përgjithshëm të të rinjve.	Të dhënat zyrtare për NEET prodhohen duke u bazuar në anketën e fuqisë punëtore. Aktualisht prodhohen vetëm në nivel vendi, në të ardhmen pritet të prodhohen edhe në nivel të regjioneve.	32.5 (TM2 2021)	20%	15%
Obj. 3	3.1. Përmirësimi infrastrukturës së transportit lokal dhe shërbimeve	<i>Infrastruktura rrugore (%)</i>	MAPL	Kjo fushë mat rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës.	Matja e këtij treguesi bëhet përmes Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK). Treguesi mbulon këto pika: rrugët e shtruara, rrugët e asfaltuara, rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave, rrugët me trotuare, rrugët me ndriçim publik, rrugët me shenjzim dhe rrugët e mirëmbajtura. Për më shumë, konsulto Raportin e Performancës së Komunave.	52% (2021)	60%	70%
		<i>Parkingjet publike (%)</i>	MAPL	Ky tregues mat se sa ka në dispozicion parkingje publike për kategori të ndryshme.	Matja e këtij treguesi bëhet përmes Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK). Treguesi mbulon këto pika: vendparkimet dhe parkingjet për mjete motorike, vendparkimet e destinuar për	47% (2021)	60%	70%

					taksi, parkingjet e rezervuara për persona me aftësi të kufizuara. Për më shumë, konsulto Raportin e Performancës së Komunave.			
		<i>Transporti publik (%)</i>	MAPL	Kjo fushë mat ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës.	Matja e këtij treguesi bëhet përmes Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK). Ky tregues mat aspektet në vijim: vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik, realizimin e planit komunal për transport publik lokal dhe vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik. Për më shumë, konsulto Raportin e Performancës së Komunave.	56.6% (2021)	65%	75%
3.2. Sigurimi i qasjes në infrastrukturë përcjellëse	<i>Popullsia me qasje në sistemet publike të ujësjellësit (%)</i>	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit	Ky tregues paraqet përqindjen e popullsisë që ka qasje në sistemet publike të ujit.	n/a	78% (2020)	92%	95%	
	<i>Popullsia me qasje në sistemet publike të kanalizimit (%)</i>	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit	Ky tregues paraqet përqindjen e popullsisë që ka qasje në sistemet publike të kanalizimit.	n/a	65% (2020)	78%	85%	
	<i>Popullsia me qasje në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza (%)</i>	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit	Ky tregues paraqet përqindjen e popullsisë që ka qasje në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza.	n/a	3 (2020)	45%	60%	
3.3. Menaxhimi i integruar i mbeturinave	<i>Mbetjet e ngurta komunale të grumbulluara</i>	Agjencia për Mbrojtjen e	Ky tregues paraqet përqindjen e mbetjeve të ngurta të grumbulluara	n/a	89.3% (2021)	90%	99%	

		<i>dhe menaxhuara në objekte të kontrolluara në totalin e mbetjeve komunale të krijuara (%)</i>	Mjedisit të Kosovës	dhe të menaxhuara në objektet e kontrolluara në totalin e mbetjeve komunale të krijuara.				
		<i>Mbetjet e ngurta komunale të ricikluara në totalin e mbetjeve komunale të krijuara (%)</i>	GIZ	Ky tregues mat tonazhin e ricikluar nga mbetjet komunale në raport me totalin e mbetjeve komunale.	Treguesi kalkulohet duke e pjesëtuar tonazhin e ricikluar me totalin e mbetjeve komunale. Riciklimi përfshin riciklimin e materialeve, kompostimin dhe tretjen anaerobe. Mbetjet komunale përbëhen kryesisht nga mbetje të gjeneruara nga familjet, por mund të përfshijnë edhe mbetje të ngjashme të krijuara nga bizneset e vogla dhe institucionet publike dhe të grumbulluara nga komuna.	2-5% (2020)	12%	30%
	3.4. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në infrastrukturë	<i>Kursimet e energjisë në infrastrukturë (%)</i>	Komunat	Ky tregues mat kursimet për energji në infrastrukturën e komunës në raport me shpenzimet sikur të mos ndërmerret asnjë masë efikase.	n/a	n/a	-30%	-60%
Obj.4	4.1. Financa lokale të qëndrueshme dhe efektive	<i>Përqindja e realizueshmërisë së buxhetit (%)</i>	MAPL	Ky tregues paraqet shpenzimet në raport me planifikimet buxhetore të komunave.	Ky tregues kalkulohet duke e pjesëtuar totalin e shpenzimeve të komunave me totalin e buxhetit të planifikuar për atë vit.	85%	90%	100%
		<i>Te hyrat vetanake – niveli komunal</i>	MFPT	Ky tregues paraqet nivelin e të hyrave vetanake të realizuara nga komunat brenda vitit.	n/a	90 mil. EUR	+20%	+30%

4.2. Avancimi i proceseve dhe resurseve në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale	<i>Niveli profesional i zyrtarëve lokalë (1-5)</i>	Indeksi i konk. së komunave (USAID)	Ky tregues paraqet nivelin profesional të zyrtarëve lokalë sipas perspektives së ndërmarrjeve.	Ky tregues është nxjerrë nga Indeksi i Konkurrueshmërisë së Komunave (IKK). Metodologjia e IKK-së bazohet në qasjen e standardizuar të Indeksit të Qeverisjes Ekonomike nga Fondacioni Aziatik. Të dhënat mblidhen përmes anketës me 3,337 firma në 38 komuna të Kosovës. Pyetja: Si e vlerësoni nivelin profesional të zyrtarëve lokalë?	3.36 (2020)	3.8	4.2
	<i>Numri i komunave me njësi për planifikim dhe zhvillim të politikave</i>	MAPL	Ky tregues paraqet numrin e komunave të cilat kanë njësi për planifikim dhe zhvillim të politikave.	n/a	0	19	38
4.3. Përmirësimi i shërbimit dhe përgjegjësisë komunale	<i>Shërbimet publike administrative</i>	MAPL	Ky tregues mat shërbimet publike administrative, efikasitetin e tyre, dhe ato që ofrohen në formën online apo përmes e-kioskut.	Matja e këtij treguesi bëhet përmes Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK). Ndahet në tri nën-fusha: shërbimet administrative gjatë vitit, shërbimet administrative brenda afateve ligjore dhe shërbimet administrative online. Për më shumë, konsultu Raportin e Performancës së Komunave.	81.7% (2021)	85%	95%
	<i>Treguesi i përgjegjshmërisë komunale (%)</i>	MAPL	Ky tregues mat nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel komunal.	Matja e këtij treguesi bëhet përmes Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK). Treguesi mat këto pika: publikimin e raporteve për procese të konsultimeve publike; dëgjimet publike për KAB dhe buxhet,	53.9% (2021)	70%	80%

					raportimin për plan të integritetit, diskutimin e raportit të auditorit të brendshëm, pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultime publike, adresimin e rekomandimeve të ZKA, diskutimet për raportet tremujore të buxhetit në KK, dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun, publikimin e njoftimeve për mbajtjen e dy takimeve publike, mbledhjet e KK me pjesëmarrje të Kryetarit, nivelin e zbatimit të planit të prokurimit dhe miratimin me kohë të propozim buxhetit. Për më shumë, konsulto Raportin e Performancës së Komunave.			
		<i>Shërbimet komunale në e-Kosova</i>	MAPL	Ky tregues paraqet numrin e shërbimeve komunale që ofrohen përmes e-Kosova.	17	n/a	+100%	+150%
4.4. Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal		<i>Numri i projekteve me komunat tjera (brenda dhe jashtë kufirit)</i>	MAPL	Ky tregues paraqet numrin e projekteve të reja me komunat tjera gjatë vitit, brenda dhe jashtë kufirit.	n/a	n/a	+40%	+80%
		<i>Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria (1-10)</i>	Indeksi i konk. së komunave (USAID)	Ky tregues paraqet masën në të cilën bizneset në Kosovë marrin pjesë në vendimmarrjen vendore dhe masën në të cilën ato konsiderojnë se qeveria është e hapur për të bashkëpunuar me ta drejt	Ky tregues është nxjerrë nga Indeksi i Konkurrueshmërisë së Komunave (IKK). Metodologjia e IKK-së bazohet në qasjen e standardizuar të Indeksit të Qeverisjes Ekonomike nga Fondacioni Aziatik. Të dhënat mblidhen përmes anketës me 3,337 firma në 38 komuna të	4.94 (2020)	6	8

				<p>arritjes së qëllimeve të përbashkëta.</p>	<p>Kosovës. Pyetjet: A jeni informuar me kohë për ndryshimet në rregulloret dhe udhëzimet administrative nga komuna? (1- kurrë, 5 - gjithnjë); Sa shpesh keni marrë pjesë në debatet publike që organizohen nga komuna? (1- kurrë, 5 - gjithnjë); Sa shpesh mendoni se rregulloret e reja komunale dhe udhëzimet administrative të ngritura gjatë debateve publike, mbrojnë interesat e bizneseve? (1- kurrë, 5 - gjithnjë); Sa shpesh prisni që rregulloret komunale të zbatohen? (1- kurrë, 5 - gjithnjë); A jeni informuar me kohë për debatet publike komunale lidhur me ndryshimet në politikat publike, rregullat dhe rregulloret komunale? (1- kurrë, 5 - gjithnjë)</p>			
--	--	--	--	--	--	--	--	--